

Raport vjetor i Entit Rregullator te Sektorit te Energjise per vitin 2008



PËRMBAJTJA

Hyrje 11

I. ANALIZA E SEKTORIT PUBLIK TE ENERGJISE ELEKTRIKE GJATE VITIT 2008	14
1.1. Struktura e Sektorit Publik te Energjise Elektrike	14
1.2. Struktura e konsumit te energjise elektrike	15
1.3. Karakteristikat e perdorimit dhe te ngarkeses se energjise elektrike.	20
1.4. Furnizimi me energji elektrike.	24
1.5. Mbi sigurine e furnizimit me energji	38
1.6. Humbjet e energjise elektrike	40
1.7. Procesi i privatizimit te Operatorit te Sistemit te Shperndarjes (OSSH).	54
II. ANALIZA E SEKTORIT PRIVAT TE ENERGJISE ELEKTRIKE GJATE VITIT 2008	59
2.1. Veprimtaria e sektorit privat te energjise elektrike.	59
III. ANALIZA E SEKTORIT TE GAZIT NATYROR NE SHQIPERI, VITI 2008.	69
3.1. Pergjegjesite e ERE-s ne Sektorin e Gazit Natyror.	69
3.2. Sektori i Gazit Natyror ne Shqiperi.	70
3.3. Lidhja e Shqiperise me Rrjetin Nderkombetar te Gazit.	73
3.4. Plani i veprimit per organizimin e veprimtarise se gazit natyror ne ERE.	77

IV. ANALIZA E VEPRIMTARISE SE ENTIT RREGULLATORTE SEKTORIT TE ENERGJISE GJATE VITIT 2008	79
4.1. Rregullimi i cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike.	79
4.2. Veprimtaria e Sektorit te Licensimit te ERE-s.	89
4.3. Veprimtaria monitoruese e ERE-s.	95
4.4. Hartimi dhe perpunimi i legjislacionit sekondar ne ERE.	98
4.5. Marredheniet e ERE-s me konsumatorin.	103
4.6. Veprimtaria nderkombetare e ERE-s.	105
4.7. Mbi marredheniet e ERE-s me Kuvendin e Shqiperise.	111
4.8. Struktura organizative dhe menyra e funksionimit te ERE-s.	112
4.9. Trajtimi i burimeve njerezore te ERE-s.	114
4.10. Administrimi i burimeve financiare te ERE-s.	116
V. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME.	118
5.1 Perfundime dhe Rekomandime.	118

Mesazh i Kryetarit të Bordit të Komisionereve



Bujar Nepravishta

Kryetar i ERE

Ne vitin 2008 ERE e konsolidoi me tej rolin e saj si institucion i pavarur ne mbrojtjen e interesave te konsumatoreve te energjise elektrike nga veprimi i efektit monopol si dhe ne optimizimin me te mire te balancave ndermjet te licensuarve, me pozicion monopol, dhe konsumatoreve.

Gjate vitit 2008 ERE rriti ne nje shkalle te re nivelin e ekspertizes profesionale, transparences dhe sherbimit ndaj qytetareve.

Per sektorin e energjise ne Shqiperi, viti 2008 ka nje rendesi te vecante, sepse shenon fundin e nje periudhe te gjate stanjacioni dhe fillimin e nje kthese te sukseseshme per kete sektor.

Ne vitin 2008, per here te pare furnizimi i konsumatoreve me energji elektrike u krye pa nderprerje te planifikuara, duke respektuar parimin e rendesishem se kostua e nje kWh te munguar ne ekonomi eshte me e madhe se cdo cmim per sigurimin e energjise elektrike te nevojshme.

Ne vitin 2008 u realizua furnizimi me i larte historik i vendit me energji elektrike. Po ashtu parimi i rritjes se eficiences se shfrytzezimit te rezerves hidroenergjetike ne kaskadat e HEC-eve, qe karakterizohet nga sasija mesatare e ujit per prodhimin e nje kWh energji elektrike ka arritur gjithashtu efektin maksimal historik.

Gjate vitit 2008 vijuan me sukses punimet per ndertimin e TEC-it te Vlores dhe linjes elektrike te interkoneksionit me Malin e Zi, objekte mjaft te rendesishem per rritjen e sigurise se furnizimit te vendit me energji elektrike. Gjate ketij viti pjesmarrja e kapitalit privat per ndertimin e HEC-eve me fuqi deri 15 MW dhe per ndertimin e parqeve eolike per prodhim energjie elektrike gjeti permasa te jashtezakoneshme.

ERE hartoi gjate ketij viti ne bashkepunim me konsulencen e financuar nga USAID-i dhe ne konsultim me institucionet perkatese te vendit, nje kuader rregullator ne sektorin e energjise elektrike, i cili u vleresua nga institucionet e specializuara nderkombetare si nje arritje e sukseseshme dhe bashkekohore.

Viti 2008 shenon kompletimin e kuadrit ligjor te sektorit te energjise ne Shqiperi edhe me ligjin "Per Gazin Natyror" dhe ne kuader te ketij ligji, delegimin te ERE, edhe te autoritetit per rregullimin ne sektorin e gazit natyror.

Por veprimtaria e ERE-s gjate vitit 2008 do te ishte e manget ne se nuk do te evidentohet puna e kualifikuar dhe me pergjegjesi te larte per promovimin dhe zhvillimin me sukses te procesit te privatizimit te OSSH-es. Procesi i privatizimit te OSSH-es perben nje nga sfidat me te rendesishme ne veprimtarine e ERE-s ne te ardhmen, por ne jemi te ndergjegjeshem qe me perpjekje te perbashketa ajo do te perballlet me sukses.

Me gjithe arritjet, ERE eshte e ndergjegjeshme, se sektori elektroenergjetik i vendit dhe ne menyre te vecante OSSH-ja, kane ende shume pune per te bere, per zvogelimin e humbjeve te energjise elektrike, per rritjen e arketimeve, per plotesimin e konsumatoreve

me matesa si dhe per rritjen e cilesise se sherbimeve ndaj konsumatoreve.

Duke perfunduar deshiroj te siguroj te gjithë te licensuarit, pjesmarres ne tregun e energjise elektrike, si dhe te gjithë qytetaret, te cilet pa perjashtim jane konsumatore te energjise elektrike, se ERE, sikunder deri me sot, edhe ne te ardhmen, do te beje te gjitha perpjekjet, per te forcuar me tej pamvarsine dhe pa-anesine e saje, transparencen dhe profesionalizmin, bashkepunimin nderinstitucional brenda dhe jashte vendit, ne menyre qe me veprimtarine e vete dhe me autoritetin vendimarres qe i atribuon ligji, te krijojë ekuilibre dhe balanca sa me optimale ndermjet paleve me interesa diverse ne tregun e energjise elektrike.

Pershendetje

Bujar Nepravishta

Bordi i Komisionereve



Ardian Hacı
Komisioner



Entela Shehaj
Komisionere



Abaz Aliko
Komisioner



Petrit Ahmeti
Keshilltar i Bordit



Zerina Pulaha
Sekretare e Bordit



Zija Kamberi
Konsulent i ERE-s

Stafi i ERE-s



Drejtoria e Monitorimit dhe Licensimit te Tregut



Drejtoria e Cmimeve dhe
Tarifave te Energjise Elektrike



Drejtoria e Ceshtjeve Ligjore dhe
Mbrojtjes se Konsumatorit



Drejtoria e Administrim, Finances, Burimeve
Njerezore dhe Marredhenieve me Jashte

HYRJE

Ne zbatim te ligjit nr.9072, date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, te ndryshuar, dhe ligjit nr.9946, date 30.06.2008 “Per sektorin e gazit natyror”, Enti Rregullator i Energjise ka hartuar Raportin Vjetor per Gjendjen e Sektorit te Energjise dhe Veprimtarine e ERE-s gjate vitit 2008, i cili paraqitet per shqyrtim ne Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, Tregtise dhe Mjedisit te Kuvendit te Shqiperise.

Mbasi analizon strukturen e sektorit publik dhe te konsumit te energjise elektrike sipas niveleve te tensionit dhe nivelit te tarifave, ne raport i behet nje analize objektive menyres se furnizimit me energji elektrike te klienteve tarifor.

Me interes te vecante eshte analiza qe i behet shfrytezimit te rezerves hidroenergjetike te kaskades se lumit Drin. Per here te pare kjo analize eshte mbeshtetur mbi nje te dhene shume objektive, qe eshte sasija vjetore e ujit qe depozitohet ne rezervuarin e HEC-it te Fierzes nga lumi Drin. Me interes eshte gjithashtu analiza e prirjeve te furnizimit me energji elektrike te klienteve tarifore gjate periudhes 2002 deri me 2008 dhe faktoret qe kane ndikuar mbi shkallen e furnizimit.

Duke qene se kushtet e sigurise se furnizimit me energji dhe ne menyre te vecante, te furnizimit me energji elektrike per periu-dhat afatshkurter dhe afatmesme, perbejne nje nga problemet me themelore te strategjise se zhvillimit te sektoreve te energjise edhe ne shkalle globale, raporti i kushton nje trajtim te vecante dhe shume te argumentuar ketij problemi.

Ne raport nje fokusim i posacem i eshte dedikuar problemit kronik dhe më shqetesues te furnizimit te vendit me energji elektrike, analizes se niveli te humbjeve te energjise elektrike dhe ne kete kontekst edhe pajisjes se klienteve me matesa te energjise elektrike.

Sfida me e rendesishme e sektorit te energjise elektrike gjate vitit 2008, ajo e privatizimit te Operatorit te Sistemit te Shperndarjes (OSSH), ze nje trajtim te posacem ne raport. Ne kete pjese te raportit vihet ne dukje e gjithë puna e kryer per hartimin e kuadrit rregullator dhe e procesit te zhvilluar per te finalizuar nepermjet nje procesi transparent, jodiskriminues dhe konkurues, fituesin e ketij procesi.

Ne nje kapitull te vecante analizohet sektori privat i energjise elektrike, ku evidentohet dukurija karakteristike e ketij viti, ajo e pjesemarrjes se gjere te investimeve private ne ndertimin e burimeve te rinj te energjise elektrike si hidrocentralet me fuqi te vogel dhe te mesme te dhene me koncension po ashtu edhe parqet eolike per prodhimin e energjise elektrike nga energjia e eres.

Per here te pare raporti me anen e nje kapitulli te vecante pasqyron veprimtarine ne sektorin e gazit natyror. Mbasi analizon historikisht situaten e gazit natyror ne Shqiperi theksi vihet mbi rruget per rikrijimin e tregut kombetar te gazit natyror si dhe projektet qe po konkurojne per kete qellim. Me tej ne raport trajtohet plani i veprimit per organizimin e rregullimit ne sektorin e gazit natyror nga ana e strukturave te ERE-s.

Nje vend me rendesi ne raport ze veprimtaria e ERE-s gjate vitit 2008 ne te gjitha aspektet e sajë, qe lidhen me sektorin e cmimeve dhe tarifave, licensimin, monitorimin e tregut dhe te licensuarve, me

veprimtarine ne fushen e hartimit te kuadrit ligjor rregullator per nje privatizim te sukseseshem te sektorit te shperndarjes se energjise elektrike, mardhenieve me konsumatorin, veprimtarise nderkombetare te ERE-s, mardhenieve te ERE-s me Kuvendin si dhe te strukture organizative, burimeve njerezore dhe administrimit te burimeve financiare te ERE-es.

Ne nje kapitull te vecante trajtohet raporti i nje eksperti kontabel te pavarur mbi auditimin e veprimtarise financiare te ERE-es gjate vitit 2008.

Ne perfundim paraqiten perfundimet dhe rekomandimet me te spikatura qe ERE evidenton mbas nje analize te veprimtarise se sektorit te energjise ne pergjithesi.

I. ANALIZA E SEKTORIT PUBLIK TE ENERGIJSE ELEKTRIKE GJATE VITIT 2008

1.1. Struktura e Sektorit Publik te Energjise Elektrike

Ne vitin 2008, sektori publik i energjise elektrike pesoi ndryshime thelbesore.

Ne kuader te miratimit te Modelit te Tregut te Energjise Elektrike te miratuar me VKM nr.338 date 19.03.2008, eshte riorganizuar KESH sh.a ne dy sektore ate te gjenerimit (KESH Gen) dhe furnizimit publik me pakice, sektore keta te ndare financiarisht dhe funksionalisht nga KESH sh.a

Me Vendimet e Bordit te Komisionereve Nr.8 dhe 9, date 25.1.2008, u be licensimi i Operatorit te Sistemit te Shperndarjes se energjise elektrike, si nje shoqeri e ndare funksionalisht, financiarisht dhe ligjerisht, e cila operon ne veprimtarite e shperndarjes, tregtimit dhe furnizimit me pakice te energjise elektrike.

Strukturat e reja u ndertuan ne perputhje me kerkesat e Modelit Shqiptar te Tregut te Energjise Elektrike dhe gjate vitit 2008 u be konsolidimi i tyre per te vepruar si te pavarura dhe te gateshme per procesin e privatizimit te OSSH-es.

Ne strategjine e zhvillimit te sektorit te energjise elektrike dhe ne ligjin nr.9072 date 22.05.2003, "Per Sektorin e Energjise Elek-

trike”, parashikohet qe OST te mbetet shoqeri publike me 100% te aksioneve shteterore, KESH-Gen parashikohet qe ne nje te ardhme afatmesme te filloje privatizimi i burimeve energjetike. Deri atehere te gjitha burimet gjeneruese ne administrim te kesaj shoqerie do te jene prone shteterore. Ndersa per OSSH-en filloi procesi i privatizimit te shumices se aksioneve te saj, sipas procedurave per te cilat ne kete raport do te flitet ne menyre specifike.

1.2. Struktura e konsumit te energjise elektrike

Struktura e konsumatoreve sipas grupimeve per vitin 2008 eshte paraqitur ne tabelen -1.1 - dhe ne grafikun e figures -1.1 –

Tabela -1.1

KONSUMATORE (SIPAS GRUPIMEVE) Viti 2008		
TOTAL. OSSH	KONSUMATORE	ENERGJI E SHITUR (000 000 kwh)
	1 042 923	4 109
Te ndara keto :		
Familjare	87.40%	55.60%
Private	11.60%	32.00%
Buxh + JoBuxh	1.00%	12.40%

Sikurse vihet re edhe per vitin 2008, konsumi me i madh i energjise elektrike rezulton nga klientet familjare me 55.6% te konsumit te pergjithshem te faturuar, me nje ulje te vogel ndaj vitit 2007 per kete kategori klientesh.

Struktura e mesiperme e konsumit te energjise elektrike, ku konsumi nga sektori privat, qe perfshin sektoret e industrise, te bujqesise, te sherbimeve, te tregtise, etj. ze vetem 32%, tregon se stadi aktual i zhvillimit te vendit tone eshte ende larg nivelit te vendeve te zhvilluara.

Nese do te merrnim ne shqyrtim dhe humbjen jo teknike, e cila perfaqeson konsumin e pafaturuar, konsumi i klienteve familjare kundrejt konsumit te pergjithshem te vendit per vitin 2008 ze 48.3%. Figura – 1.2 - paraqet ecurine e ketij raporti ne % per periudhen 1985 deri ne 2008. Duhet te themi se dy vitet e fundit verehet nje prirje pozitive drejt uljes se konsumit familjar, ndonese furnizimi i pergjithshem me energji elektrike ka ardhur duke u rritur.

Figura -1.1






Figura -1.2 - (Burimi Evidenca e KESH- sha & OSSH)




Struktura e konsumit te energjise elektrike sipas nivelit te tensionit eshte paraqitur ne tabelen -1.2 -, kurse ne figuren -1.3 - ajo eshte shprehur ne forme grafike. Numri me i madh i klienteve rezulton i lidhur ne tensionin e ulet dhe po ashtu edhe pjesa dermuese e energjise elektrike te faturuar shitet ne tension te ulet. Kjo si pasoje e predominimit ne konsumin e energjise elektrike, i klienteve familjar dhe i bizneseve te vogla, te cilet furnizohen ne tensionin e ulet te rrjetit te shperndarjes. Nje tipar i tille i struktures se furnizimit me energji elektrike shprehet edhe nga pikpamja e konfiguracionit te rrjetit, shkallen ende te ulet te industrializimit te vendit dhe te numrit te vogel te bizneseve te mesme dhe te medha. Ne figuren -1.3- eshte paraqitur ne menyre grafike kjo maredhenie.

Tabela – 1.2 – (Burimi Evidenca OSSH)

KLIENDET SIPAS TENSIONEVE Viti 2008			
	KLIENDET (numri)	SASIA E SHITUR (aktive) (gwh)	SASIA E SHITUR (reaktive e pa konsoliduar) (gwh)
GJITHSEJ	1 042 923	4 109	60
TE NDARA KETO:			
NE T.U.	99.5 %	75.1 %	0.2 %
NE T.M.	0.499 %	19.3 %	80.6 %
NE T.L.	0.001 %	5.6 %	19.2 %

Figura -1.3. (Burimi Evidenca OSSH)



Nje tregues i rendesishem i cili ndikon ndjeshem ne te ardhurat e shoqerise, e cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike, ne menyre qe ato te sherbejne ne menyre sa me reale per mbulimin e kostove te sherbimit te shoqerise, eshte struktura e shitjes se energjise elektrike sipas cmimeve te miratuara per vitin 2008. Ne tabelen -1.3 - eshte paraqitur kjo strukture shitjeje, kurse ne figuren – 1.4 - paraqitja grafike e saj.

Duke ju referuar kesaj strukture shitjeje, vërehet se pjesa kryesore e energjise elektrike te faturuar i perket konsumatoreve familjare te bllokut te pare, me konsum mujor te energjise elektrike deri ne 300 kWh.

Nga kjo analize konstatohet se numri i klienteve familjare te bllokut te pare rezulton 70 % e numrit te pergjithshem te klienteve familjare. Ky raport mendojme se eshte i ekzagjeruar, cka do te thote se nuk e perligj konceptin mbi te cilin eshte ngritur arsyetimi per krijimin e blloku te pare, si bllok qe merr ne mbrojtje shtresat e konsumatoreve me te ardhura te pakta ose te quajtura “ne nevoje”. Ky konstatim perligjet edhe nga studimi qe eshte duke u kryer nga ERE per vleresimin e nevojave minimale per energji elektrike per kategorine e konsumatoreve ne nevoje.

Figura – 1.4 (Burimi Evidenca OSSH)




Tabela – 1.3 – (Burimi Evidenca OSSH)

ENERGJIA E SHITUR SIPAS CMIMEVEVE Viti 2008		
CMIMI (LEKE/KWH)	NUMRI ABONENTEVE	SASIA E SHITUR (Kwh)
	1042923	4109244000
TE NDARA KETO (ne %):		
5.2	0.0001	5.6
7	69.59	28
7.5	0.23	2.3
8	0.35	14.9
8.5	0.17	2.8
9.5	0.03	0.9
10	11.95	17.5
12(buxh.)	0.001	0.3
12	17.68	27.8

Gjate vitit 2009 ERE do ta rikonsideroje sasine e energjise elektrike per bllokun e pare, ne menyre qe ajo te zgjidhet me sa më objektivitete dhe t'i sherbeje qellimit per te cilin zbatohet.

Persa i perket struktures se konsumit te energjise elektrike eshte e nevojshme te veme ne dukje se edhe gjate vitit 2008, ndonese eshte i liberalizuar plotesisht kufiri i konsumit vjetor te energjise elektrike, qe nje subjekt te perfitoje statusin e Klientit te Kualifikuar, per te gjithë klientet jo familjare, deri me sot vetem nje klient ka preferuar te dali ne treg dhe te zgjedhi furnizuesin e tij. Te gjithë klientet e tjere jo familjare kane zgjedhur te mbeten kliente tarifore, d.m.th. te furnizohen me energji elektrike nga Furnizuesi Publik.


1.3. Karakteristikat e perdorimit dhe te ngarkeses se energjise elektrike.

Nga pikepamja makroekonomike mund te themi se treguesit specifik te energjise elektrike shprehen me:

- a- Intensitetin e energjise elektrike, i cili tregon se sa energji elektrike ne kWh i perket 100 Leke te Produktit te Brendshem Bruto (PBB), per vitin 2008 rezulton 0.71 kWh/00Leke PBB
- b- Konsumin specifik te energjise elektrike per fryme te popullsisë (kWh/banor), i cili per vitin 2008 rezulton 1987.3 kWh/banor (Popullsia me 1 Janar 2008 sipas Instat rezulton 3.170.048 banore).
- c- Peshen specifike te energjise elektrike mbi PBB, te shprehur ne %, e cila per vitin 2008 rezulton 1.46 %.


Ne grafikun e figures -1.5 - paraqitet pesha specifike qe ze energjia elektrike ne PBB per vitet 2006, 2007 dhe 2008 si dhe parashikimi per vitin 2009. Megjithese pjesa qe ze energjia elektrike ne PBB eshte e vogel, impakti i mungeses se saj ne ekonomi eshte i larte.

Fig. -1.5 - (Burimi: Te dhena nga Emerging Europe Monitor dhe Vleresime te ERE)



Ne analizen e punes se sektorit te energjise elektrike merr rendesi edhe investigimi i karakterit te ndryshimit te ngarkeses elektrike gjate dites, vitit dhe tendencat e ecurise ne periudha disa vjecare. Ne figuren -1.6- jane paraqitur grafiket ditore te ngarkeses maksimale ne nje dite dimri si dhe te ngarkeses minimale ne nje dite vere.

Fig. – 1.6 -(Burimi: Te dhena nga OST)




Karakteristike e grafikut ditore të ngarkesës për vitin 2007 ishte shformimi i tij nga trajta normale me 2 pike, (nje ne mengjes dhe nje ne mbremje) dhe kalimi ne grafikun ditore të ngarkesës me 3 ose edhe 4 pike për shkak të ndërprerjeve të detyruara të energjisë elektrike, kurse gjatë vitit 2008 grafiku ditore i ngarkesës për efekt të mungesës së ndërprerjeve të detyruara të energjisë elektrike ka ndryshuar sikurse vihet re në figurën -1.6- dhe ka vetëm dy pike normale.

Për vitin 2007, mesatarja e ngarkesës maksimale mujore rezultoi 1,063 MW, ndërsa mesatarja e ngarkesës minimale mujore rezultoi 284 MW kurse për vitin 2008 këto parametra janë përkatësisht 1109 MW dhe 339 MW sikurse tregohet në grafikun e figurës -1.7 - Edhe për vitin 2008 koeficienti i mbushjes së grafikut të ngarkesës është i vogël. Një grafik i tillë është tipik për ato vende ku prodhimi industrial është modest dhe ngarkesa elektrike dominohet nga klientët familjarë, nga shërbimet dhe veprimtaritë tregtare.

Ngarkesa pikë vjetore për vitin 2007 rezultoi 1,340 MW ose 93% e gjithë kapacitetit të instaluar gjenerues të vendit. Në vitin 2008 ajo rezultoi me 1397 MW ose 97 % e kapacitetit gjenerues të instaluar prej 1440 MW. Në figurën – 1.7.- paraqitet profili i ngarkesës elektrike për çdo muaj të vitit 2008 (vlefat minimale, mesatare dhe maksimale).

Vlera e pikut pothuaj sa kapaciteti gjenerues i vendit tregon se kemi te bejme me nje sistem energjetik te brishte, i cili e ka te pamundur te perballoje flukset e ngarkeses maksimale dhe per pasoje te garantoje sigurine e furnizimit te vendit nga pikpamja e kapacitetit gjenerues, pasi nga pikpamja e energjise ne jemi nje vend importues neto qe nga viti 1998, ne kete kontekst mer rendesi te madhe ndertimi i burimeve te reja gjeneruese, efektet e te cilit do te ndjehen duke filluar nga viti 2009.

Fig - 1.7 – (Burimi te dhena nga OST)




1.4. Furnizimi me energji elektrike.

Viti 2008 perfaqeson, per efekt te kushteve hidrologjike nje vit te thate te barasvlershem me vitin 2007. Furnizimi me energji elektrike i konsumatoreve te OSSH-es per vitin 2008 ka qene 6.300 TWh (teravatore). Nga e cila 3.770 TWh jane prodhim vendi) dhe 2.417 TWh jane energji elektrike e importuar.

Sikurse vihet re, gjate vitit 2008, prodhimi vendas i energjise elektrike perben 60 % te konsumit te pergjithshem, ndaj 51.0% qe perbente ne vitin 2007. Ne grafikun e figures -1.8. - eshte paraqitur konsumi historik i energjise elektrike qe nga viti 1985 dhe deri sot.

Figura -1.8. - (Burimi Evidencat KESHsh.a.)



Sikurse vihet re, furnizimi me energji elektrike i konsumatoreve gjate vitit 2008, perfaqeson nje rekord historik, ai eshte me i larti i arritur deri me sot.

Per te analizuar tendencat e furnizimit me energji elektrike ne kohen e sotme i jemi referuar periudhes 2002 deri 2008, duke e konsideruar si periudhen me te stabilizuar mbas asaj te trazirave te vitit 1997, dhe te nje tranzicioni deri ne 2002.

Ne vitin 2008 i tere prodhimi i energjise elektrike ne vend eshte realizuar vetem nga burimet hidroenergjetike, si i tille ai ka qene i lidhur ngushte me kushtet hidro-meteorologjike.

Ndonese niveli i prurjeve gjate periudhes 2007 dhe 2008 ka qene sa ai i viteve 2001- 2002, furnizimi i klienteve ne vitin 2007 ishte 5% me i larte se ai i vitit 2002 kurse ne vitin 2008, 16% me i larte.

1.4.1. Analiza e shfrytezimit te rezerves hidroenergjetike.

Per te analizuar me objektivitet cilesine e punes se KESH-it ne shfrytezimin e rezerves hidroenergjetike i jemi referuar nje treguesi shume me te sakte ne vleresimin e kushteve hidrologjike, dhe pikerisht sasise vjetore te prurjeve qe shpije lumi Drin ne rezervuarin e Fierzes.

HEC-i i Fierzes, me rezervuarin e tij, perfaqson burimin kryesor te energjise elektrike ne sistemin tone energjetik, mbasi pervec prodhimit me te madh vjetor, ai siguron edhe nje rregullim vjetor te kaskades se lumit Drin.

Ne tabelen -1.4 - jane paraqitur ne menyre te permbledhur treguesit me sintetik te veprimtarise se KESH-it gjate periudhes 2002 deri 2008.

Tabela – 1.4. –(Burimi evidenca KESH sha)

Emertimi	Viti						
	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Prodhimi (GWh)	3,204	4,974	5,467	5,409	5,516	2,933	3,770
Importi (GWh)	2,072	937	567	365	633	2,828	2,417
Furnizimi (GWh)	5,430	5,900	5,945	5,933	6,121	5,750	6,300
Sasia vjetore e Ujit (Miljard,m3)	4.44	5.8	7.81	6.74	6.52	4.11	4.12
Konsumi specifik (m3/kWh)	1.38	1.17	1.43	1.25	1.18	1.40	1.04

Duke ju referuar prurjeve te lumit Drin ne Fierze, vihet re se vitet 2007 dhe 2008 kane qene vite edhe me te thate se viti 2002 qe eshte konsideruar si nje nga vitet me te thata. Ndonese eshte keshtu, KESH-i ne vitin 2008 ka realizuar per here te pare treguesin rekord te eficiences se shfrytezimit te rezerves hidroenergjetike per te gjithë periudhen qe nga viti 1985.

Ne vitin 2008, ne kaskaden e Drinit, 1 kWh energji elektrike eshte prodhuar vetem me 1.04 m³ uje, cka do te thote, se pothuajse per te njejten sasi uji me ate te vitit 2007, ne vitin 2008 eshte prodhuar mbi 30% energji elektrike me shume, ose ndonese ne vitin 2002 sasija e ujit ka qene 7.7% me e madhe se ne vitin 2008, eshte prodhuar 23.4% me shume energji elektrike kundrejt vitit 2002.


Ne vitin 2008 KESH-i arriti per here te pare, nepermjet nje harmonizimi te kenaqshem te importeve gjithëvjetore te energjise elektrike, me perpunimin racional te rezerves hidroenergjetike ne kaskade, te ruaj kuota te larta shfrytezimi te liqenit te Fierzes, gjate gjithë vitit, e per pasoje te prodhoje shume me teper energji elektrike per te njejten sasi uji te shfrytezuar.

Ne figuren -1.9 - eshte paraqitur grafiksht maredhenia ndermjet prodhimit te energjise elektrike ne vend, me importin dhe furnizimin e konsumatoreve per cdo vit gjate periudhes 2002 – 2008. Maredhenia ndermjet prodhimit te energjise elektrike dhe sasise se ujit qe eshte

shfrytezuar per prodhimin e kesaj energjie si dhe treguesi i konsumit specifik te ujit jane paraqitur grafiksht ne figuren -1.10 –

Ne grafikun e figures -1.11 - jane paraqitur per krahasim kuotat e nivelit te liqenit te Fierzes gjate vitit 2007 dhe 2008. Eshte me rendesi te theksojme se pothuajse gjate gjithe vitit 2008 kuota e shfrytezimit eshte mbajtur ne menyre te vazhdueshme rreth 15 metra me e larte se kuotat respektive te vitit 2007.

Figura – 1.9 – (Burimi Evidena KESH sha)



Sasija e prurjeve mesatare vjetore te lumit Drin ne rezervuarin e Fierzes, per periudhen 2002 – 2008, eshte paraqitur ne grafikun e figures -1.12 –

Shihet qarte se prurjet gjate viteve 2007 dhe 2008 kane qene me minimalet e te gjithe periudhes 2002 – 2008.

Figura -1.10 –(Burimi te dhena KESH sha)




Figura – 1.11 –(Burimi te dhenave nga OST)





Figura -1.12- (Burimi te dhena nga OST)

1.4.2. Analiza e prirjeve te furnizimit me energji elektrike.

Per te analizuar prirjet e furnizimit me energji elektrike te klienteve i jemi referuar periudhes 2002 - 2008. Ne tabelen - 1.5 - ne menyre te permblodhur jane paraqitur treguesit sintetik, tekniko-ekonomik, te standarteve te furnizimit me energji elektrike per periudhen 2002 – 2008.

Ne kete analize jane marre ne konsiderate prirjet e furnizimit me energji elektrike, prirjet e cmimeve mesatare te importit, prirjet e nderprerjeve te energjise elektrike si dhe prirjet e shfrytzezimit te rezerves hidroenergetike.

Duke ju referuar te dhenave te tabelës -1.5- dhe grafikut te figures -1.9 - vihet re se deri ne vitin 2006 prirja e furnizimit te vendit me energji elektrike ka qene stanjative dhe eshte ruajtur nje nivel i pandryshuar furnizimi me rreth 5,900 GWh ne vit, ndonese kerkesa per energji ka ardhur duke u rritur dhe ndonese kushtet hidrologjike

kane qene shume te favorshme per te pasur nje furnizim me te madh me energji elektrike. Natyrisht ne kete prirje kemi perjashtuar vitin 2002, i cili eshte konsideruar nje vit teper i thate. Vetem ne vitin 2006 kemi nje prirje per te rritur furnizimin me energji elektrike, duke kapercyer nivelin e 6,100 GWh ne vit. Natyrisht edhe ne kete prirje kemi perjashtuar vitin 2007 i cili eshte vleresuar gjithashtu si vit teper i thate.


Ne grafikun e figures -1.13- eshte paraqitur prirja e importeve te energjise elektrike gjate periudhes 2002 – 2008.

Tabela -1.5- (Burimi te dhena nga KESH & OSSH)

Emertimi	Viti						
	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Prodhimi (GWh)	3,204	4,974	5,467	5,409	5,516	2,933	3,770
Importi (GWh)	2,072	937	567	365	633	2,828	2,417
Çmimi mesatar i importit (Euro/MWh)	30.18	30.15	35.57	40.04	47.81	69	79
Vlera e Importit (000Euro)	62,534	28.261	20.172	14.628	30,246	195.132	190.943
Furnizimi (GWh)	5,430	5,900	5,945	5,933	6,121	5,750	6,300
Sasia vjetore e Ujit (Miljard,m3)	4.44	5.8	7.81	6.74	6.52	4.11	4.12
Konsumi specifik (m3/kWh)	1.38	1.17	1.43	1.25	1.18	1.4	1.04
Ndalesat e energjise (GWh)	960	662	556	664	412	891	200
Ndalesat e energjise (ore/dite)	4.3	2.9	2.3	2.7	1.6	3.4	0.3

Vihet re se mbas vitit 2006 ka nje prirje per rritje te theksuar te importeve te energjise elektrike ne krahasim me periudhen paraardhese. Kjo prirje ka ardhur se pari si pasoje e zvogelimit te prodhimit vendas per shkak te kushteve jo te favorshme hidrologjike por edhe si pasoje e nje pergjegjeshmerije dhe vullneti me te madh per te furnizuar vendin me sa me shume energji elektrike.

Figura – 1.13. – (Burimi te dhena nga KESH, OSSH)



Ne grafikun e figures -1.14.- eshte paraqitur prirja e cmimeve mesatare te importit te energjise elektrike gjate periudhes 2002 – 2008.

Duke analizuar te dhenat e ketij grafiku vihet re me lehtesi se mbas vitit 2006 ne tregun rajonal te energjise elektrike ka pasur nje rritje me ritme shume te larta te cmimit mesatar te energjise elektrike. Ne se gjate periudhes 2002 – 2006 rritja mesatare vjetore e cmimit te importit ka qen me 4.4 Euro/MWh ne vit, per periudhen 2006-2008 ka qen me 15.6 Euro/MWh ne vit.

Prirja e ndryshimit te cmimit te importit te energjise elektrike eshte nje parameter i cili nuk varet nga shoqerite tona publike te energjise. Lidhur me kete tregues, nga Furnizuesi Publik me Shumice dhe nga OSSH-ja, te cilet jane importuesit e energjise elektrike per furnizimin e konsumatoreve tarifar, varet aftesia e tyre menaxheriale qe ne nje konjunktur te caktuar te tregut rajonal te energjise elektrike te lidhin kontrata importi sa me te leverdiseshme.

Ne grafikun e figures -1.15- eshte paraqitur prirja e ecurise se shpenzimeve per importin e energjise elektrike gjate periudhes 2002 – 2008.

Prirja e ndryshimit te shpenzimeve per importin vjetor te energjise elektrike eshte nje tregues i cili varet nga shume faktor. Se

pari ai varet nga cmimet e importit dhe sasija e energjise elektrike qe do te importohet ne vitin perkates. Ai varet nga kufizimet financiare qe i krijohen shoqerive publike per efekt te tarifave te rregulluara te energjise elektrike per klientet tarifor, qe sipas metodologjise i referohen cmimeve te importit te vitit paraardhes.

Figura – 1.14. –(Burimi te dhena KESH & OSSH)





Figura – 1.15-(Burimi te dhena nga KESH & OSSH)




Kjo prirje lidhet gjithashtu me impaktin qe jep mbi PBB-ne dhe ekonomine ne pergjithesi 1 kWh i munguar, e ne kete rast eshte Qeverija qe nderhyn per kompensimin e ketij efekti. Kjo prirje pa dyshim eshte edhe efekt i drejtperdrejte i efciences se shfrytezimit te rezerves hidroenergjetike, i prodhimit vendas te energjise dhe rritjes se efciences menaxheriale te kompanive publike ne teresi, cka do te thote se si punojne ato per zvogelimin e humbjeve dhe rritjen e arketimeve nga shitja e energjise elektrike.

Optimizimi i te gjithë ketyre faktoreve pa dyshim qe do te ishte zgjidhja me e mire ne kushtet reale.

Nje tregues shume i rendesishem i cilesise se furnizimit me energji elektrike te konsumatoreve eshte treguesi i nderprerjeve te energjise elektrike, i shprehur ne numer nderprerjesh dhe kohezgjatje te tyre.


Ne vendet e zhvilluara perendimore zakonisht konsiderohen si nderprerje te shkurtera te energjise elektrike, ato nderprerje te cilat zgjasin me shume se 1 sekonde, por me pak se 3 minuta, ndersa nderprerje te gjata konsiderohen ato nderprerje te cilat zgjasin me shume se 3 minuta.

Figura -1.16 –(Burimi te dhenave nga Rap.Vjetor i Rreg. Italian 2007)



Ne grafikun e figures -1.16 - eshte paraqitur kohezgjatja e nderprerjeve te energjise elektrike, ne minuta ne vit, kurse ne grafikun e figures -1.17 - eshte paraqitur numri i nderprerjeve, per kohe te shkurter, per kohe te gjate dhe numri total i nderprerjeve te energjise elektrike, ne rrjetin e shperndarjes te Italise, per cdo vit te periudhes 2002 deri ne 2007. Ne Itali, ne baze te ketyre te dhenave, numri i pergjithshem i nderprerjeve ne tension te ulet ne vitin 2007 ka qene afro 7 nderprerje per konsumator ne vit, ndersa kohezgjatja e tyre vjetore nuk ka kaluar 58 minuta per cdo konsumator.

Figura-1.17 –(Burimi te dhenave nga Rap. Vjetor i Reg. Italian 2007)



Me keqardhje duhet pranuar se ne rrjetin tone te shperndarjes numri vjetor i nderprerjeve vleresohet ne disa qindra, ndersa kohezgjatja e tyre per cdo konsumator me disa ore ne dite.

Per here te pare ne praktiken e furnizimit me energji elektrike, ne vitin 2008 nuk u programuan nderprerje te planifikuara te energjise elektrike. Kjo dukuri shenon nje moment kthese me rendesi ne cilesine e furnizimit me energji.

Per te mos pasur ndonje keqkuptim, kur shprehemi per nje furnizim pa nderprerje me energji elektrike te klienteve, ne pranojme ne kontekstin e kesaj shprehjeje, nderprerjet per shkak te defekteve dhe avarive ne sistemin e furnizimit me energji, nderprerjet per shkak te remonteve te planifikuara te linjave dhe nenstacioneve, nderprerjet per shkak te rikonstruksioneve si dhe nderprerjet per shkak te forcave madhore te natyres.

Nga ana tjetere duhet te pranojme qe ne kushtet aktuale te konfiguracionit te rrjeteve, te gjitha niveleve te tensionit ne sistemin tone energjetik, te shkalles se ulet te automatikes koomutuese (kycese, ckycese), te nje rezerve te kufizuar kapacitetesh transformuese, procesi i shkurtimit te kohes se rivendosjes se situates energjetike normale mbas nje defekti ose avarije si dhe mundesite e kufizuara te rezervimit gjate remonteve apo rikonstruksioneve bejne qe koha e nderprerjeve te furnizimit me energji te jete shume me e gjate se ne vendet e zhvilluara. Ne aktualisht ndodhemi ne nje proces permiresimi hap pas hapi te ketij faktori, i cili nuk do te jete shume i shpejte, per shkak se shoqerohet me investime te konsiderueshme.

Gjate vitit 2008 nderprerjet e energjise elektrike kane qene per shkaqe te perligjura te cilat i kemi spjeguar me larte, por gjithashtu na duhet te pohojme se ka pasur edhe disa nderprerje abuzive nga zona te caktuara te OSSH-es me qellim permiresimin e indeksit te humbjeve te energjise ne zonat perkatese, cka perben nje dukuri te palejueshme.


Ne grafikun e figures – 1.18 - jane paraqitur vlerat vjetore te energjise elektrike te furnizuar konsumatoreve tarifore dhe nderprerjet e energjise elektrike te shprehura ne vlerë energjie (GWh) si dhe te shprehura ne kohe nderprerjeje (ore/dite), per periudhen 2002 – 2008.

Duke analizuar kete grafik vihet re se nderprerjet me te thella kane ndodhur ne vitet ku prodhimi i vendit i energjise elektrike ka qene minimal (vitet 2002 dhe 2007).

Te terheq vemendjen fakti se ne vitet 2003, 2004 dhe 2005, ndonese kane qene vite me prurje te larta te lumit Drin (perkatesisht

5.80; 7.81 dhe 6.74 miliard m³ uje ne vit), furnizimi me energji elektrike ka qene i ulet, mesatarisht me 5,926 GWh/vit, ose 6.3% me i ulet se furnizimi i vitit 2008 kur prurjet ishin vetem 4.12 miliard m³.

Figura -1.18 – (Burimi te dhena nga KESH,OSSH)



Ne praktiken menaxheriale te zbatuar nga KESH-i, ne periudhen deri ne vitin 2007, nuk ka egzistuar si objektiv furnizimi pa nderprerje i klienteve tarifar, por furnizimi i tyre eshte programuar me nderprerje te planifikuara. ERE gjykon se ne vitet 2003, 2004 dhe 2005 ekzistonin te gjitha kushtet favorizuese per te pasur nje furnizim me te mire me energji elektrike ose per te pasur ne menyre te ndjeshme me pak nderprerje energjie per klientet tarifar.

Viti 2008 eshte viti i pare ne te cilin nuk palanifikohen nderprerje te eenergjise elektrike per konsumatorët. Nderprerjet e energjise per kete vit nuk kane kaluar 25 minuta ne dite per cdo klient, dhe kryesisht ato kane ndodhur te klientet familjare, ndersa te kategorite e biznesit ne pergjithesi, nderprerjet mund te themi se kane qene fare te parendesishme.

Gjate viteve 2007 dhe 2008 vihet re nje rikonceptim i rendesise se furnizimit me energji elektrike te klienteve tarifar. Vetem ne keto dy vite u importuan 5,278 GWh energji elektrike ose 15.4% me shume se importet e tere periudhes 2002-2007 dhe u shpenzuan per blerje energjie elektrike nga importi 388.7 milion Euro ose 2.5 here me shume se shpenzimet e te gjithë periudhes 2002-2007.

Nga kjo analize ERE arrin ne konkluzionin e rendesishem se parimi i furnizimit pa nderprerje te programuara me energji elektrike te klienteve tarifar, duke marre parasysh impaktin e rende ekonomiko-social qe shkakton 1 kWh i munguar ne jeten e vendit, i koordinuar me parimin e rritjes domethenese te efciences ne praktiken manaxheriale te shoqerive publike duhet te perbejne kriteret themelore udheheqese te punes se tyre.

ERE ne baze te ketyre parimeve do te organizoje te gjithë punen e saje vendim-marrese per vleresimin e cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike ne te ardhmen por edhe per monitorimin dhe vleresimin e shoqerive publike te sektorit te energjise elektrike. Persa i perket evidentimit te nderprerjeve te energjise elektrike, OSSH nuk ka evidenca te sakta te numrit te nderprerjeve ne rrjetin e shperndarjes ne shkalle vendi, kurse koha e nderprerjes llogaritet ne menyre te terthorte nepermjet diferences se energjise te planifikuar per furnizimin e konsumatoreve dhe asaj te furnizuar realisht..

E rendesishme eshte qe praktika e planifikimit te furnizimit pa nderpreje te klienteve me energji elektrike, e realizuar gjate vitit 2008, te mbetet nje standart i detyrueshem dhe i qendrueshem, mbasi energjia elektrike, sikurse dihet, eshte pjese e menyres se sotme te egzistences se shoqerise njerezore.

ERE me te drejte, punen e kryer nga KESH-i, OSSH-ja dhe OST-ja gjate vitit 2008, si nje vit me nje numur te madh faktoresh te disfavorshem, te cilet u permenden me lart, dhe me nje furnizim rekord me energji elektrike, pa nderprerje te planifikuara dhe me efciencen me te larte te shfrytezimit te rezerves hidroenergjetike deri

me sot, e vlereson ne menyre te merituar si nje model menaxhimi me te mire por nga ana tjeter objektivat per zvogelimin e humbjeve dhe rritjen e arketimeve i vlereson ende te papermbushura.

1.5. Mbi sigurine e furnizimit me energji

Siguria e furnizimit te konsumatoreve me energji elektrike perfaqeson nje koncept integral qe shpreh ne menyre sintetike standardin e njerit prej sherbimeve me jetike te njerezimit.

Siguria e furnizimit eshte nje funksion kompleks me shume variable. Se pari ajo shpreh, shkallen e mundesise se furnizimit te vendit me energji elektrike, sipas standardeve te cilesise, te pranuarra nderkombetarisht, nepermjet burimeve gjeneruese te vendit apo importit, qofshin ato konvencionale apo te riperteriteshme. Nga ana tjeter merr ne konsiderate rritjen mesatare vjetore te kerkeses per energji dhe rruget per mbulimin e kesaj kerkese ne terma afatshkurter dhe afatgjate.

Siguria e furnizimit trajton nevojën për burime të reja gjeneruese dhe mënyrën e realizimit të tyre. Ajo merr në konsideratë rezervën operative dhe rezervën e ftohtë në burime gjeneruese, linja, dhe njësi transformuese. Një drejtim tjetër është ai që ka të bëjë me rritjen e efikasitetit të rezervës hidroenergjetike dhe të optimizimit të parametrave të sistemit elektro-energjetik kombëtar. Siguria e furnizimit lidhet me integrimin sa më efektiv rajonal dhe evropian të sistemit elektro-energjetik nepermjet linjave të interkoneksionit për të siguruar import-eksporte të energjisë elektrike me terma ekonomike sa më të leverdiseshme.

Se fundi Siguria e furnizimit është edhe funksion i shkallës së automatizimit dhe dispecerimit të sistemit elektro-energjetik në të gjitha funksionet, ato të OST-es, OSSH-es dhe Gjenerimit.

Në pikëpamje të riskut politik, që përfaqëson një vend edhe në drejtim të sigurisë së furnizimit me energji elektrike, mund të themi se shkalla e këtij risku minimizohet me integrimin e Shqipërisë në

strukturat Euro-Atlantike dhe futjen ne vend te investimeve te me-dha strategjike.

Gjate vitit 2008 mund te themi se problemet e rritjes se sigurise se furnizimit te vendit me energji elektrike kane perfaqsuar nje politike te qarte shteterore per nxitjen e ndertimit te burimeve te reja gjeneruese nepermjet shfrytezimit te potencialeve kombetare energjetike dhe inkurajimit dhe terheqjes se investimeve private ne sektorin e energjise.

Nepermjet nje politike koncensionare konkurruese e transparente dhe te mbeshtetur ne nje kuader te plote ligjor dhe nenligjor u be e mundur qe te nenshkruhen dhe miratohen nga Qeverija, 31 kontrata koncensionare, per ndertimin e HEC-eve me fuqi te vogel te mesme dhe te madhe, me investitore vendas dhe te huaj. Aktualisht, ne nje periudhe afatmesme prej 3-6 vjet pritet te futet ne shfrytezim nje potencial gjenerues hidroelektrik prej rreth 530 MW qe parashikohet te prodhoje, mbas venies ne shfrytezim, nje sasi energjie elektrike nga burime te rinovueshme prej 1.76 miljard kWh ne vit, ose rreth 28% te sasise.

Ne tabelen -1.6 - eshte paraqitur nje pasqyre e plote e te gjithë HEC-eve te dhene me koncension.

Gjate vitit 2008 filluan punimet per ndertimin e TEC-it te Vlo-res, me kapacitet te instaluar prej 98 MW dhe nje prodhim vjetor prej rreth 650 GWh, nje investim ky i KESH-it me kredi nga Banka Bote-rore, BERZH dhe Banka Evropiane e Investimeve. Deri tani punimet kane ecur sipas programit dhe ne Qershor te ketij viti parashikohet venia ne pune e ketij centrali. Me ndertimin dhe futjen ne shfrytezim te ketij centrali, permiresohet Siguria, per periudhen afatshkurter.

Gjate vitit 2008 filluan gjithashtu punimet e ndertimit te linjave te transmetimit Tirane – Podgorice dhe Tirane – Elbasan, me tension 400 kV dhe me kapacitet transmetues 1,000 MW, nepermjet te cilave behet i mundur interkoneksioni i sistemit tone elektro-energjetik me aksin verior te transmetimit, Mal i Zi, Bosnje-Herzegovine. Keto

linja qe financohen perkatesisht nga Qeverite Gjermane dhe Italiane parashikohet te perfundojne ne shtator te ketij viti dhe do te bejne te mundur permiresimin e rrugeve te import-eksportit te energjise elektrike ne treguan rajonal, duke ndikuar keshtu pozitivisht ne rritjen e sigurise se furnizimit te vendit me energji elektrike.

Gjate vitit 2008 Qeveria Shqiptare ka miratuar lejet per ndertimin e dy linjave te transmetimit kabllor nenujore me tension 400kV dhe kapacitet transmetues 500 MW secila, midis Shqiperise dhe Italise.

Ne praktiken e vendeve te zhvilluara te botes rritja vjetore e kerkeses per energji elektrike vleresohet mesatarisht me 1%, kurse ne vendin tone, duke u nisur nga praktika 25 vjecare e furnizimit te vendit me energji elektrike, rritja e kerkeses vleresohet mezatarisht me 3.3% ne vit.

Mbeshtetur ne kete tregues si dhe ne skenarin e parashikimit te kerkeses per energji sipas Strategjise Kombetare te Energjise dhe duke e harmonizuar ate edhe me programin e reduktimit te humbjeve te energjise elektrike krijohen kushte per nje planifikim sa me objektiv te kerkeses per energji per cdo vit.

ERE e vlereson vitin 2008 nga pikpamja e sigurise energjetike si vitin e fundit, me shkalle te ulet te sigurise ne furnizimin e konsumatoreve me energji elektrike, qe mbyll nje etape historike 25 vjecare stanjacioni, pa burime te reja gjeneruese dhe pa asnje linje te re interkoneksioni.

1.6. Humbjet e energjise elektrike

Nje nga problemet me te rendesishme, i cili ne menyre kronike ndikon ne uljen e efciences se perdorimit te energjise elektrike, ne rritjen e pamotivuar te kerkeses per energji elektrike si dhe ne rritjen e cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike mbetet problemi i humbjeve te energjise elektrike te cilat prej vitesh jane shume me te medha se ato qe evidentohen ne sistemet normale elektroenergjetike

te vendeve te zhvilluara.

Humbjet e energjise elektrike, perفشire ato teknike dhe jo teknike, perfaqesojne sfiden me te veshtire dhe me efektin me te rende demtues ne veprimtarine ekonomiko-financiare te OSSH-se. Ato deshmojne njekohesisht edhe per punen e madhe qe ende duhet te behet ne menyre qe ky problem te gjeje zgjidhjen e duhur.

Humbjet teknike dhe jo teknike te energjise elektrike ne rrjetin e shperndarjes per vitin 2007 kane rezultuar me 35.4%, ndersa humbjet e pergjitheshme, duke perفشire edhe ato ne transmetim rezultojne me 2,080 GWh ose 36.4 %.

Tabela -1.7-(Burimi te dhena nga OSSH)

ZONA	Energji e marre nga sistemi	Energji e Faturuar		Humbjet Teknike		Humbjet JoTeknike		Humbje Gjithsej
	000 kwh	000 kwh	%	000 kwh	%	000 kwh	%	%
TIRANE	1932321	1379643	71,4	328475	17,0	224203	11,6	28,6
DURRES	729303	496286	68,0	130726	17,9	102291	14,0	32,0
FIER	689524	490051	71,1	115729	16,8	83744	12,1	28,9
KORCE	263225	198283	75,3	44862	17,0	20079	7,6	24,7
ELBASAN	384776	290886	75,6	65210	16,9	28680	7,5	24,4
BERAT	347467	249522	71,8	60722	17,5	37223	10,7	28,2
SHKODER	582932	321299	55,1	109138	18,7	152495	26,2	44,9
KUKES	151349	77508	51,2	29379	19,4	44461	29,4	48,8
BURREL	317738	209427	65,9	57708	18,2	50603	15,9	34,1
GJIROKASTER	235908	180858	76,7	38248	16,2	16801	7,1	23,3
TOTALI OSSH	5634533	3893763	69,1	980987	17,4	760580	13,5	30,9

Shenim: Te dhenat e Tabeles se mesiperme jane llogaritur pa humbjet ne Tension te Larte.


Per vitin 2008 humbjet e pergjitheshme teknike dhe jo teknike ne rrjetin e shperndarjes, ne saje te nje pune me te mire, por ende te pamjaftueshme, te strukturave te OSSH-se, rezultojne me nje vlefte prej 1,927 GWh ose me 32.74 % pra me nje reduktim prej 2.66 %.

Humbjet e pergjitheshme te energjise elektrike per vitin 2008 rezultojne me 2140 GWh, dhe ne perqindje 33.99%. Ne menyre me te detajuar, humbjet teknike ne shperndarje rezultojne me 1167 GWh, ose 19.8%, kurse humbjet jo teknike rezultojne me 760GWh, ose 13.5%. Ecuria e humbjeve totale te energjise ne funksion te energjise elektrike te furnizuar te konsumatoret per periudhen 2002-2008 eshte shprehur grafikisht ne figuren – 1.19.

Kontrata Konkensionare te miratuara me Vendimin e Keshillit te Ministrave						
Nr	Emertimi HEC-it	Subjekti	Vera e investimit	Njesia	Fuqia e Vendosur KW	Energjia kWh
1	Egnantia	“Remi” shpk	321,956,600	leke	5,000	22,000,000
2	Tervol	“Bler-Klo-Ar” shpk	325,800,167	leke	10,000	40,000,000
3	Verbe-Selce	“Xhemi 02” shpk	287,310,000	leke	2,800	16,540,770
4	Qyteze	“Muso” shpk	27,700,000	leke	250	1,350,000
5	Carshove	“Korsel” shpk	83,500,000	leke	1,200	6,300,000
6	Sllabinje	“LNK” shpk	1,290,117,487	leke	9,300	50,000,000
7	Labinot Mal-Elbasan	“Ansera” shpk	12,500,000	leke	250	1,300,000
8	Stebleve	“ Stebleva” shpk	159,680,320	leke	3,400	12,600,000
9	Lapaj	“Spahiu Gjanc” shpk, “ Fatjon” shpk, “S.G.A” sha, “ Armemil” shpk	1,453,500,000	leke	12,600	52,400,000
10	Lengarica 1, Lengarica 2	“Hasi Energy” shpk	1,980,904,000	leke	6,200	35,700,000
11	Peshku	“Koka” shpk	188,055,946	leke	1,900	11,580,000
12	Stravec	“Koka” shpk	870,315,194	leke	6,000	25,620,000
13	Kacni	“K.I.S.I” shp	133,121,000	leke	1,100	6,772,032
14	Kabash 1, Kabash 2	“Adnain” shpk	671,000,000	leke	5,200	32,005,729
15	Stravej	“Mak Olimpik” shpk	503,529,364	leke	3,626	16,317,000
16	Tucep 2	“Duka T2 “ shpk	166,000,000	leke	1,400	7,500,000
17	Strelca 1, Strelca 2, Strelca 3	“Busa” shpk	1,084,000,000	leke	6,126	43,233,264
18	Lura 1, Lura 2, Lura 3	“Erdat” shpk	1,300,177,500	leke	10,993	53,308,264


19	Rapuni 1, Rapuni 2	“C&S Contraction” shpk	749,080,000	leke	8,250	44,650,000
20	Suha 2	“Albaenergjiaplus” shpk	360,000,000	leke	3,400	7,300,000
21	Bistrica 3 e 4	“Bistrica 3” shpk	756,400,000	leke	2,553	17,823,000
22	Mertanesh	“ Sigers” shpk	857,961,985	leke	3,600	12,000,000
23	Selite	“ IRZ” shpk	120,000,000	leke	1,300	8,563,000
24	Vlushe	“Aurora Contraction” shpk	1,715,320,000	leke	14,200	65,000,000
25	Stojan	“ El-Er Energy” shpk	124,333,623	leke	1,400	6,000,000
26	Prelle 1, Prelle 2	B.sh.” Endi-E’, “ EKO A2” shpk	1,512,585,536	leke	7,800	35,800,000
27	Holta Kabash, Holta Polican	“ Atlas” sha	500,000,000	leke	4,700	23,300,000
28	Bistrica 1 e Bistrica 2	B.sh”Titan” shpk, “Osmani” shpk	250,000,000	leke	2,950	12,910,000
29	“ Orgjost I Ri”, “ Bele 1”, “ Bele 2”, Topojan 1” Topojan 2”	B.sh:” Euron” shpk, ‘ Kadria” shpk, “ Teuta Konstruction” shpk	3,565,744,707	leke	24,260	108,537,038
30	Ashta	OSTERREICHISCHE ELEKTRIZITAT- SEIRTSCHE AFTSAKTIENGE- SELLSCHAFT	19,520,000,000	leke	48,200	
31	Kaskada e Devollit	“ EVN”			319,000	985,400,000
	Shuma		40,890,593,429	leke	528,958	1,761,810,097

Figura – 1.19 – (Burimi te dhena nga KESH & OSSH)




Duke ju referuar te dhenave te ketij grafiku vihet re se qe nga viti 2006 e deri me sot, ka nje tendence pozitive, te renies se vazhdueshme dhe me tempe te ndjeshme te nivelit te humbjeve. Ne grafikun e Figures -1.20. - paraqitet ecuria e humbjeve te energjise elektrike gjate ketyre 25 viteve te fundit qe nga viti 1981. Duke shqyrtuar kete grafik konstatohet lehte se, qe nga viti 1995 e deri sot, perpjekjet per te zvogeluar humbjet e energjise elektrike nga te gjitha ekipet menaxhuese te KESH-it nuk kane qene te sukseseshme.

Figura – 1.20 – (Burimi: Strategjia Kombetare e Energjise e perditesuar me te dhenat e KESH)



Per te kryer nje analize me te detajuar dhe ne menyre kapilare te struktures se humbjeve te energjise elektrike ne cdo Zone Shperndarje te vendit, ERE ka identifikuar te dhenat e paraqitura ne tabelen – 1.7 - Sikurse vihet re rezultatet me te dobeta jane perkatesisht ne Zonen e Kukesis ku humbjet totale ne shperndarje jane 48.8%, ne Zonen e Shkodres me 44.9%, ne Zonen e Burrelit me 34.1% dhe ne zonen e Durresit me 32.0%. Ne figuren – 1.21 - rezultatet e paraqitura ne tabelen – 1.7 - jane shprehur grafikisht.

Figura -1.21 – (Burimi te dhena nga OSSH)



Per te gjykuar per arritjet dhe per punen qe duhet kryer nga strukturat e OSSH-se, ne menyre qe perparasite e vemendjes te foku-sohen atje ku reduktimi i humbjeve sjell ndikimin me te larte pozitiv ne rezultatit perfundimtar, ERE i eshte referuar peshes specifike qe zene humbjet e cdo zone, mbi humbjet totale.

Per kete, ne radhe te pare, eshte gjykuar e arsyeshme qe te pa-raqitet pesha specifike qe ze cdo zone e OSSH-se ne furnizimin e konsumatoreve me energji elektrike.

Ne tabelen – 1.8 - eshte paraqitur pesha specifike e cdo zone ne furnizimin e klienteve me energji elektrike. Ne forme grafike kjo marredhenie eshte paraqitur ne figuren – 1.22 –

Tabela - 1.8 – (Burimi te dhena nga OSSH)

ZONAT (OSSH)	Energji e marre nga sistemi	Pesha Specifike Energji e marre
TIRANE	1932321	34,3
DURRES	729303	12,9
FIER	689524	12,2
KORCE	263225	4,7
ELBASAN	384776	6,8
BERAT	347467	6,2
SHKODER	582932	10,3
KUKES	151349	2,7
BURREL	317738	5,6
GJIROKASTER	235908	4,2
TOTALI OSSH	5634533	100,0

Ne figuren – 1.21 - eshte paraqitur pesha specifike qe zene faturimet e energjise elektrike, humbjet teknike dhe humbjet jo teknike mbi totalin perkates ne shkalle OSSH-je perkatesisht te faturimeve dhe humbjeve teknike dhe jo teknike.

Nga kjo analize rezulton se vemendja e OSSH-se per zvogelimin e humbjeve duhet te fokusohet ne radhe te pare ne Zonat e Tiranes, Shkodres, Durresit dhe Fierit.

Marredhenia ndermjet nivelit te humbjeve dhe nivelit te arketimeve, eshte shprehur nga ana e ERE-s me faktorin e efektivitetit te shitjes se energjise nga OSSH. Ne grafikun e figures – 1.24 - eshte paraqitur ecuria e procesit te faturimeve dhe arketimeve te energjise elektrike gjate periudhes 2002- 2008.

Figura -1.22 – (Burimi te dhena nga OSSH)





Figura – 1.23 – (Burimi: Evidenca KESH&OSSH)



Ne menyre grafike efektiviteti i shitjes eshte paraqitur ne figuren – 1.24 -

Per procesin e faturimit te energjise elektrike, mund te themi se gjate vitit 2008 ka pasur parregullsi persa i perket sasive te faturuara per klientet, disa here.


Kurse ne tabelen – 1.9 - eshte paraqitur faktori i efektivitetit te shitjes se energjise elektrike per cdo zone te OSSH-se per vitin 2008. Vetem Zonat e Shperndarjes te Korces, Elbasanit dhe Gjirokastrës rezultojne me efektivitetin me te larte, ndersa zonat e tjera, e ne menyre te vecante, Kukesi, Shkodra, Durresi, Burreli e Tirana kane efektivitet te ulet.

Tabela – 1.9 –(Burimi te dhena nga OSSH)

EFEKTIVITETI I SHITJES Viti 2008 (sipas zonave te OSSH-se)			
	ARKETIMI %	HUMBJET %	EFEKTIVITETI %
KORCE	97.99	24.7	74
ELBASAN	97.01	24.4	73
GJIROKAST.	94.56	23.3	73
BERAT	95.98	28.2	69
FIER	85.02	28.9	60
TIRANE	81.53	28.6	58
BURREL	82.21	34.1	54
DURRES	74.89	32	51
SHKODER	72.21	44.9	40
KUKES	28.82	48.8	15

Nuk eshte respektuar intervali mujor i faturimit por eshte faturuar ne intervale pertejmujore, cka ka sjelle nje pagese suplementare dhe te padrejte nga ana e klienteve. Klienteve me mates te demtuar shpesh ju faturohet energjia ne menyre aforfe duke mos respektuar dispozitat e Kodit te Matjes per kete rast. Disa here ne llogaritjen e demit ekonomik te shkaktuar nuk zbatohen metodikat perkatese por veprohet arbitrarisht. Gjithashtu duhet evidentuar fakti se nuk kryhet faturimi per klientet me lexim zero te matesit, po ashtu nuk kryhet faturimi per energjine e pikut per klientet qe duhet te perfshihen ne kete kategori. Sasija e energjise reaktive qe faturohet i perket nje numri shume te vogel klientesh dhe shpesh nuk kryhet ne perputhje me rregullat dhe procedurat perkatese.

Figura – 1.24 - (Burimi te dhena nga OSSH)



Eshte me vend te theksohet se OSSH-ja per efekt te gjithë ke-tyre te metave peson nje dem te ndjeshem financiar nga arketimi i munguar per keto kategori klientesh.

ERE e gjykon te domosdoshme dhe i rekomandon OSSH-se qe te marre masa te menjehereshme per te permiresuar ne menyre rrenjesore punen ne strukturen e Furnizuesit Publik me Pakice me synimin qe ne menyren e faturimit te gjeje rruge dhe mundesi per nje lexim te matesave qe eliminon subjektivizmin e lexuesve dhe rrit transparencen ndaj klienteve.

OSSH-ja duhet te marre masa urgjente ne menyre qe programi (softi) i perdorur ne sherbimin e faturimit te energjise elektrike te marre ne konsiderate rritjen e madhe te numrit te klienteve dhe te perballoje te gjitha kerkesat qe kane te bejne jo vetem me faturimin, por edhe me evidentimin e nje numri te madh informacionesh te tjera te cilat jane shume te nevojshme per te bere analiza dhe per te nxjerre perfundime me rendesi per miremenaxhimin dhe monitorimin e shoqerise.

1.6.1 Pajisja me matesa e klienteve te energjise elektrike.

Plotesimi me matesa i klienteve te energjise elektrike nga ana e OSSH-es perben nje nga problemet per te cilat as KESH-i, me perpara dhe as OSSH-ja aktualisht nuk kane mundur t'i japin zgjidhje. Pa dyshim kjo dukuri perben nje pergjegjesi te ketyre shoqerive mbasi per disa vite rresht ato jane angazhuar ta zgjidhin kete problem, por per arsye nga me te ndryshmet ai ka mbetur nje shqetesim kronik pa zgjidhje perfundimtare.

Historikisht ne 1 janar 2005 numri i pergjithshem i klienteve familjare pa matesa rezultonte 152,373. Gjate viteve 2005 dhe 2006 u shtuan edhe 90,122 kliente te rinj familjare, dhe numri i pergjithshem i klienteve familjare, qe kerkonin matesa gjate kesaj periudhe arriti ne 242,495. Ne 1 janar 2007 numri i pergjithshem i klienteve familjare pa matesa rezultonte me rreth 63,000 ose gjate periudhes 2005-2006 jane instaluar gjithesej 179,495 matsa te rinj. Gjate vitit 2007, duke ju referuar te dhenave operative te KESH-it te muajit dhjetor 2007 situata paraqitet sikurse tregohet ne tabelen – 1.10 –

Duke marre parasysh se shtimi mesatar vjetor i numrit te klienteve te rinj te KESH-it eshte rreth 40,000, rezulton se gjate vitit 2007 KESH-i nuk ka pajisur asnje klient me mates, ndonese ne aplikimin e tij per shtyrjen e afatit te faturimit aforfe deri ne 31 Dhjetor 2007 ai zotohej se do te plotesonte pa perjashtim te gjithe klientet me mates.

Gjate vitit 2008 numri i klienteve te OSSH-se u rrit nga 998,745, qe ishte ne fund te vitit 2007 ne 1,042,923 kliente, pra me 44,178 ose 4.4% kliente me shume.

OSSH-ja e realizoi gjate vitit 2008 pajisjen me matesa te rreth 80 mije klienteve pa matesa, ashtu sikurse ishte planifikuar. Ky kontingjent matesash ishte parashikuar ne vitin 2007 se do te mjaftonte per te mbuluar nevojat per matesa te te gjithe klienteve.

Tabela- 1.10 –(Burimi te dhena nga OSSH)

Kategoria	Me Matje	Pa Matje		Gjithsej
		Ne sasi	Ne %	
Familjare	790,740	87,132	11	877,872
Private	96,498	14,674	15	111,172
Shteterore	8,164	1,537	19	9,701
Gjithesej	895,407	103,343	11.5	998,745

Gjate vitit 2008 numri i klienteve te rinj u rrit me 44,178 kliente, dhe nga ana tjeter, OSSH ne saje te punes per identifikimin e perdoruesve te paligjshem te energjise elektrike, beri legalizimin e tyre gje qe mundesoi shtimin e numrit te klienteve me faturim aforfe.

Aktualisht numri i klienteve me faturim aforfe eshte reduktuar ne 63,590.

Duke ju referuar situates se mungeses se matesave ne cdo zone te OSSH-es, rezultatet i kemi permbledhur ne Tabelen – 1.11 -

Tabela -1.11 – (Burimi te dhena nga OSSH)


Numri i abonenteve sipas zonave 2008							
Zonat e OSSH	Me matje		Matesa te demtuar		Pa matje		Gjithsej
	Sasia	%	Sasia	%	Sasia	%	
Tirane	220521	89,04	7223	2,92	19914	8,04	247658
Durres	129203	91,77	811	0,58	10782	7,66	140796
Fier	129949	94,28	0	0,00	7883	5,72	137832
Shkoder	83512	82,82	0	0,00	17323	17,18	100835
Elbasan	98771	99,82	46	0,05	129	0,13	98946
Berat	95794	98,76	356	0,37	848	0,87	96998
Korce	88824	99,59	356	0,40	12	0,01	89192
Burrel	57851	97,21	241	0,40	1420	2,39	59512
Gjirokast.	49575	98,73	4	0,01	633	1,26	50212
Kukes	15164	72,41	1132	5,41	4646	22,19	20942
Totali OSSH	969164	92,93	10169	0,98	63590	6,10	1042923

Duke analizuar te dhenat e kesaj table, se pari vihet re se zonat qe kane perqindjen me te larte te klienteve pa matesa, ne krahasim me numrin e pergjithshem te klienteve te zones perkatese, jane Kukesi me 22.19% dhe Shkodra me 17.19%. Se dyti, duke ju referuar numrit absolut te klienteve pa matesa ne zonat e shperndarjes, konstatohet se vetem ne 4 zona, dhe pikerisht ne Tirane, Shkoder, Durres dhe Fier, jane pa matesa 55,902 abonente, qe perbejne 88% te numrit te pergjithshem te abonenteve pa matsa.

Ne figuren – 1.25 - jane paraqitur grafikusht te dhenat e tabelës se me sipërme.

ERE-ja gjykon se perpara nje dukurije te tille OSSH-ja duhej te kishte kompletuar me matesa ne radhe te pare zonat Korçe, Elbasan, Gjirokaster dhe Berat, per te cilat, ne te gjitha se bashku mungojne vetem 1622 matsa dhe ne kete menyre perjashtoheshin krejtesisht nga faturimi aforfe 4 zona te rendesishme te vendit.

Figura – 1.25 - (Burimi te dhena nga OSSH)



ERE i ka kerkuar OSSH-se qe per vitin 2009 te llogarise mire nevojen per matesa duke marre ne konsiderate klientet e rinj, por dhe ata qe do te rezultojne nga identifikimet, te cilet marrin energji ne menyre te paligjeshme si dhe matesat e demtuar pa mundesi riparimi, ne menyre qe te shteren te gjitha argumentet te cilat deri me sot kane synuar te perligjin pa argumenta bindes faturimin aforfe.

ERE me kerkese te OSSH-se, me Vendimin Nr.144, date 30.12.2008 miratoi shtyrjen per te treten here afatin e faturimit aforfe deri me 31 dhjetor 2009.

Duke qene se OSSH-ja ndodhet ne fazen finale te procesit te privatizimit, dhe ERE do te vendoste qe te mos e lejonte faturimin aforfe, atehere te gjitha klientet pa matesa nuk do te paguanin energjine elektrike dhe ne kete menyre OSSH do te penalizohej per mosrespektimin e detyrimit te saj me nje dem te ndjeshem financiar. Shoqeria ceke CEZ qe pritet te privatizojë OSSH-ne nuk mban asnje pergjegjesi pse klientet nuk jane te pajisur me matesa, per pasoje nuk do te ishte e drejte dhe e pranueshme qe ti transferohet nje penalizim i tille, mbas procesit te privatizimit.

ERE-ja mbeshtetur ne keto argumente e gjykoi te arsyeshem marrjen e vendimit te mesiperm, por nga ana tjeter na duhet te theksojme se shoqeria private do te jete shume me e interesuar se deri me sot per pajisjen e te gjith klienteve me matesa, mbasi sikurse dihet, klientet me faturim aforfe e perdorin energjine elektrike pa limit, c'ka do te thote se ata paguajne vetem nje pjese te energjise qe konsumojne sipas tarifimit aforfe, duke sjelle nje dem te ndjeshem financiar per shoqerine. Duke qene keshtu, eshte e natyrshme te pritet qe gjate vitit 2009, shoqeria private CEZ ta kete nder prioritetet kryesore plotesimin me matesa te klienteve dhe ne kete menyre, ky problem, shpesh i neglizhuar dhe i zvarritur prej vitesh, te gjeje zgjidhjen perfundimtare.

Eshte me rendesi te theksohet se ne ERE, nga ana e klienteve pa matesa nuk eshte paraqitur asnje ankese, pse ata vazhdojne te fatu-

rohen aforfe, kjo per arsyen e thjeshte se keta kliente paguajne vetem nje pjese te energjise elektrike te konsumuar pa limit. Mesatarisht faturimi aforfe paguhet ne sasive 430 kWh/muaj ose 4392 lek/muaj (me gjithë TVSH), ndersa konsumi mesatar sipas disa parashikimeve mund te jete mbi 600 kWh/muaj.

Eshte gjithashtu kjo arsyeja perse disa prej klienteve te kesaj kategorie klientesh kundershton pajisjen e tyre me matesa. Per fat te keq OSSH-ja, qe eshte e demtuara kryesore ne kete dukuri, nuk ka bere perpjekjet e duhura per eleminimin e ketij fenomeni.

1.7. Procesi i privatizimit te Operatorit te Sistemit te Shperndarjes (OSSH).

Historikisht KESH-i u krijua ne vitin 1994 si shoqeri aksionere me 100% te aksioneve te zoteruara nga Shteti Shqiptar. Deri ne vitin 2004 ajo funksionoi si shoqeri vertikalisht e integruar me aktivitetete te gjenerimit, transmetimit, shperndarjes, furnizimit dhe import-eksportit te energjise elektrike.

Ne 1 Gusht 2004, veprimtaria e transmetimit u shkeput nga KESH-i dhe u krijua Operatori i Sistemit te Transmetimit (OST), si nje entitet ligjerisht, financiarisht dhe organizativisht i pavarur nga KESH-i.

OST-ja u licensua nga ERE per te zhvilluar aktivitetet e meposhteme:

- Per Operimin fizik te Sistemit te Transmetimit, me funksionet e mirembajtjes dhe zhvillimit te metejshe me tij si Operator i Rrjetit te Transmetimit.
- Per Dispecerimin e Sistemit Elektroenergjetik si Operator i Drejtimit te Sistemit
- Si Operator i Tregut te energjise elektrike.

Me Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr.862, date 20.12.2006 u krijua “Operatori i Sistemit të Shperndarjes”, (OSSH). Nje gje e tille u arrit nga ndarja e Divizionit të Shperndarjes, ne perberje të KESH-it, dhe krijimit të OSSH-es si nje entitet i pavarur nga KESH-i, ligjerisht, financiarisht dhe organizativisht.

Ky ishte nje hap shume i rendesishem per pergatitjen e aktivitetit të shperndarjes per privatizim. ERE e licensoi OSSH-ne per te kryer aktivitetet e shperndarjes, ku perfshiheshin mirembajtja, zhvillimi dhe operimi i sistemit elektrik të shperndarjes. Nga ana tjetër OSSH-ja është e ngarkuar të kryejë shërbimin e lidhjes në rrjetin e shperndarjes me terma jodiskriminuese të Klienteve Tarifor, të Prodhuesve të Vegjel të Energjisë Elektrike dhe të Klienteve të Kualifikuar.

Me Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr.338, date 19.3.2008, u miratua Modeli Shqiptar i Tregut të Energjisë Elektrike, në baze të të cilit strukturohej tregu shqiptar i energjisë elektrike, mardheniet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, rolet dhe përgjegjësitë përkatëse si dhe roli rregullator i ERE-s në këtë treg.

Disa nga parimet përcaktuese të këtij modeli kanë të bëjnë me alokimin e riskut hidrologjik të Furnizuesit Publik me Shumice, një entitet ky në perberje të KESH-it, i cili vijon të mbetet një shoqëri publike me 100% të aksioneve të zotëruara nga shteti. Në këtë mënyrë, edhe për një periudhë të caktuar, shteti do të vazhdojë të marrë përgjegjësitë e garantimit të furnizimit të vendit me energji elektrike në rastet e thatësirave kur prodhimi vendas është i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat për energji.

Modeli autorizon OSSH-ne që të blejë energjinë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve nëpërmjet importit, mase kjo që ka për synim të stimulojë reduktimin e humbjeve nga ana e OSSH-se.

Brenda OSSH-se është vendosur gjithashtu shërbimi i Furnizuesit Publik me Pakice, i cili e blen energjinë elektrike nga Furnizuesit Publik me Shumice, dhe ja shet me cmime të rregulluara, të miratuara nga ERE, vetëm klienteve tarifor.

Ne baze te Modelit i jepet perparesi perdorimit te prodhimit vendas te energjise elektrike nga HEC-et per te plotesuar ne radhe te pare nevojat e klienteve tarifore.

Gjate vitit 2006, Qeverija Shqiptare nisi procedurat per privatizimin e OSSH-es nepermjet shitjes se paketes kontrolluese te aksioneve te shoqerise (76%), investitoreve strategjik private, ne perputhje me procedurat qe parashikohen ne ligjin per prokurimet publike, ne ligjin per privatizimin e sektoreve strategjik te ekonomise, ne Vendimet e Keshillit te Ministrave per kete problem etj.

Ne Mars 2008, Kuvendi miratoi ligjin Nr.9889, date 20.03.2008 “Per formen dhe strukturen e formules per privatizimin e OSSH-se”

Nepermjet procesit te privatizimit te OSSH-se synohet:

- Te sigurohet nje sherbim i furnizimit te klienteve me energji elektrike ne menyre te panderprere, dhe me eficence te larte.
- Te konsolidohet nje OSSH financiarisht e shendoshe dhe teknike e teknologjike e standarteve bashkekohore.
- Te mundesohet futja e investitoreve strategjike dhe e kapitalit privat per investime te rendesishme ne sistemin elektrik te shperndarjes.
- Te krijohet dhe te konsolidohet nje treg konkurues i energjise elektrike ne perputhje me Acquis Communautaire te BE-se dhe me Traktatin e Komunitetit te Energjise si dhe te integrohet ai ne tregjet rajonale dhe evropiane te energjise elektrike.

Nje rol te rendesishem, per funksionimin e sukseseshem, te tregut, sipas kerkesave te parashtruara me siper, luan krijimi i nje kuadri rregullator te plote dhe sipas standarteve me te perparuara te kohes.

ERE ne bashkepunim me konsulencen e kualifikuar nderkombetare, te financuar nga USAID, e cila po asiston ne kete proces, krijoi nje kuader rregullator, te plote dhe te arrire. Ne kete kuader rregullator jane trajtuar:

- Rregullat e tregut.
- Kodet e rrjeteve te transmetimit dhe shperndarjes si dhe kodi i matjes.
- Metodologjite e tarifave te energjise elektrike si dhe te gjitha sherbimeve te ofruara nga te licensuarit ne tregun e energjise elektrike.
- Unifikimin e llogarive te te licensuarve sipas standarteve nderkombetare te kontabilitetit.
- Procedurat e licensimit, transferimit dhe modifikimit te licensave etj.

Eshte me rendesi te vihet ne dukje, se procesi i privatizimit erdhi si nje vazhdim i natyrshem i strategjise kombetare te zhvillimit ekonomik te vendit dhe si nje rrjedhim logjik i nje procesi transformimesh te KESH-it. Ai vleresohet si nje proces konkurues i paanshem dhe transparent, nen efektin balancues dhe rregullator te ERE-s.

Gjate 6 mujorit te pare 2008 u zhvilluan shume takime promocionale, ne te cilat investitoreve te huaj pjesmares, ju prezantohej OSSH-ja, kuadri rregullator dhe procedura e privatizimit. Ne vijim roli i ERE-s ka konsistuar ne hartimin e “Deklarates Rregullatore” e cila sherbeu si baze e rendesishme ne negociatat me te gjitha kompanite qe moren pjese ne procesin e privatizimit. Deklarata permban termat ekonomiko financiare si dhe detyrimet qe duhet te permbushe investitori ne procesin e manaxhimit te OSSHse, mbas privatizimit.

ERE zhvilloi disa raunde takimesh me te gjitha shoqerite pjesmarrese ne tender dhe ne perfundim u arrit me finalizimin e Deklarates Rregullatore te miratuar nga ERE me 9 Shtator 2008, e cila eshte botuar dhe ne Fletoren Zyrtare.

Ne tenderin nderkombetar qe u zhvillua nga (Ministria e Ekon. Tregtise dhe Energjise (METE) me 29 Shtator 2008 u shpall fituese shoqeria ceke “CEZ”.

Mbas kesaj METE krijoi nje grup nderinstitucional per zhvillimin e negocitave me CEZ, per lidhjen e kontrates se privatizimit.

Duhet te theksojme se negociatat pergjithesisht jane nje proces ne te cilin asnjera nga palet pjesmarrese nuk mund te realizoje te gjitha kerkesat e saj maksimale. Gjate ketij procesi ka tolerime nga secila pale, por edhe vendosmeri per t'i qendruar deri ne fund kushteve qe vleresohen te panegociushme. Ndonse negociatat po zhvillohen ne nje kontekst nderkombetar te pafavorshem, per shkak te krizes ekonomike globale, mund te themi se ato jane drejt perfundimit dhe shume shpejt pritet neneshkrimi i kontrates.

Me kerkesen e METE-s, ERE do te shqyrtoje dhe miratoje Deklaraten Rregullatore, ne te cilen do te pasqyrohen ndryshimet qe mund te jene arritur gjate procesit te negocimit te kontrates. Me pas kontrata me Deklaraten Rregullatore si aneks, do te miratohet nga Keshilli i Ministrave dhe do te ratifikohet nga Kuvendi, sic edhe parashikohet nga ligji.

Ne gjykojme se me detyrimet qe merr persiper CEZ-i qe te zvogeloje humbjet e energjise elektrike nga niveli aktual prej 32% ne 15%, ne fund te tre periudhave te para rregullatore (ne viti 2014), si dhe me detyrimet per rritjen e arketimeve, futjen e teknologjive dhe standarteve te reja te sherbimit dhe pergjegjesive ndaj konsumatorit, pritet qe procesi i privatizimit te jete i sukseseshem.

Eshte me rendesi te theksohet se procesit i privatizimit eshte zhvilluar me nje transparence te plote dhe perfaqesimi i institucioneve shqiptare, pjesmarrese ne te, ka qene dinjitoz dhe me nivel te lart profesional.

II. ANALIZA E SEKTORIT PRIVAT TE ENERGJISE ELEKTRIKE GJATE VITIT 2008

2.1. Veprimtaria e sektorit privat te energjise elektrike.


Sektori privat i energjise elektrike gjate vitit 2008 eshte perfaq-suar nga 15 shoqeri private per prodhimin e energjise elektrike me gjithesej 46 HEC-e me fuqi te instaluar deri 10 MVA. Nga keto 7 jane kompani koncensionare ndersa 8 jane shoqeri private.

Politika e Qeverise ndaj ketij sektori ka qene nje politike nxitese dhe inkurajuese per zhvillimin sa me efektiv te tyre me objektiv rritjen e prodhimit te energjise elektrike nga burimet hidrike lokale dhe zhvillimin e punesimit dhe infrastruktures ne zonat me te thella rurale.

Ne grafikun e figures – 2.1. - eshte paraqitur ecuria e cmimeve te energjise elektrike te miratuara nga ERE per periudhen 2004 - 2008, me te cilat keta prodhues e kane shitur energjine elektrike te prodhuar prej tyre ne KESH, ne nje treg te garantuar nga shteti. Sikurse vihet re, ka pasur nje tendence te vazhdueshme te rritjes se cmimeve per ti lejuar ketyre subjekteve te licensuara qe te krijojne mundesi rinovimi teknik dhe teknologjik te objekteve te tyre.

Sikurse tashme eshte e njohur, vitet 2007 dhe 2008 kan qene hidrologjikisht vite mjaft te thata, cka eshte reflektuar me nje renie prodhimi edhe nga ana e HEC-eve me fuqi te vogel.

Figura – 2.1. –Burimi nga ERE



Ne Tabelen – 2.1 - eshte paraqitur struktura e prodhimit te energjise elektrike nga keta gjenues per periudhen 2004 – 2008. Ndonese viti 2008 ishte nje vit i thate ai perfaqson prodhimin me te lart te te gjithë periudhes me 62.026 GWh. Megjithese prodhimi i energjise elektrike ne vitin 2008 eshte vetem 0.17% me i larte se ai i vitit 2006, te ardhurat nga shitja e energjise elektrike kane qene 16.9 % me te larta, cka tregon ne menyre te dukeshme mbeshtetjen qe ju eshte dhene ketyre subjekteve per rinovim teknologjik dhe rritje te eficiences nga centralet e tyre. Ne grafikun e figures – 2.2. - eshte paraqitur ecuria e prodhimit te energjise elektrike te realizuar nga HEC-et me fuqi te vogel gjate periudhes 2004 – 2008 kurse ne grafikun e figures – 2.3. - eshte paraqitur ecuria e te ardhurave per keto burime, gjate se njeites periudhe.

Duhet theksuar se edhe gjate vitit 2008 ka pasur raste te lenies jashte pune te disa HEC-eve te vegjel, vecanerisht ne zonen veriore te vendit. Nje gje e tille ka ardhur kryesisht per arsye objektive teknike, si pasoje e pamundesise se komutimit te skemes elektrike ose te rikonstruksionit te linjave teper te gjata ne tension te mesem, ne menyre qe keta centrale te lidhen me efience me zonat ku jane te vendosur.

Tabela – 2.1 – (Burimi nga ERE)

Prodhimi i HEC-eve te vegjel ne GWh/vit					
	2004	2005	2006	2007	2008
Albanian Green Energy	10,454	16,679	28,087	25,348	23,634
Balkan Green Energy	10,480	12,627	13,360	15,612	18,980
Emikel	5,017	3,195	2,985	2,638	2,781
Amal	1,000	1,136	545	868	1,020
Spahiu-Gjanc	6,727	4,993	5,382	4,941	3,850
Wonder-Power sh.a.	6,356	5,726	5,492	3,663	4,297
HEC-et koncesionare	40,357	44,660	56,112	53,070	54,562
		11%	26%		3%
Projeksion	550	0	0	423	796
Sarolli	118	191	45	21	344
Juana	210	183	260	187	196
WTS energji	135	336	848	530	1,006
Marjakaj	0	197	330	397	353
Maksi Elektrik	383	549	561	672	764
Favina	0	846	3,342	3,877	4,003
Dardania	0	0	0	0	0
HEC-et private	1,248	2,629	5,806	6,107	7,464
		111%	121%	5%	22%
Totali	41,605	47,289	61,918	59,177	62,026

Figura – 2.2. –(Burimi ERE)





Figura – 2.3 – (Burimi nga ERE)



Megjithate edhe shkalla e interesimit te OSSH-es per investime qe mundesojne shfrytezimin maksimal te kapacitetit prodhues te ketyre centraleve nuk ka qene e mjaftueshme dhe per rjedhoje ka pasur nderprerje te gjata te prodhimit dhe mosshfrytezim me eficence te rezerves ujore.

Prodhimi gjithesej nga sektori privat ne vitin 2008 perbente vetem 0.99 % te konsumit te pergjithshem te energjise elektrike ne shkalle vendi. Per Centralet e vegjel me fuqi te instaluar deri 10 MVA, duke mare parasysh HEC-et e Bistrices-2 Lanabregasit, Thethit dhe Lures, te cilet jane prone publike e KESH-it, prodhimi i pergjithshem i energjise elektrike per vitin 2008 ishte 130.629 GWh ose 2.09 % e gjithe konsumit ne shkalle vendi.

Ne Tabelen 2-2 paraqitet nje pasqyre permbledhese e treguesve kryesor te ketyre subjekteve gjate periudhes 2004-2007. Per periudhen 5 – vjecare te operimit te tyre, (qe nga viti 2003, kur keto hidrocentrale u privatizuan apo u dhane me koncension), ERE eshte mbeshtetur ne planin e investimeve te detyrueshem per t'u zbatuar

nga koncesionaret sipas marreveshjes koncesionare, duke i reflektuar ne cmimin e miratuar vit pas viti. Ne kete menyre, sic mund te verehet dhe ne grafikun e Figures -2.1.- ketyre prodhuesve u eshte dhene mundesia qe per periudhen 2004 - 2008 te rrisin eficensen e shfrytezimit te ketyre burimeve si pasoje e mundesise per rritje te investimeve.

Nderkohe, ERE ne zbatim te metodologjise se lartpermendur per keto HEC-e, ne muajin shkurt 2008 miratoi nje cmim prej 6.5 leke/kWh per vitin 2008 ose nje rritje prej 4.8 % ne krahasim me vitin 2007.



*Shkembim Pervoje me Rregullatorine e Pensilvanise, Harisburg
12-14 Maj*



*Shkembim Pervoje me
Rregullatorine e Pensilvanise,
Harisburg 12-14 Maj*



*Takim me perfaqses
te USAID-it dhe
NARUK-ut,
Washington D.C.
15 Maj*



*Takim me Perfaqses
te Rregullatorit Federal
te SHBA-se, "FERC"
Washington D.C.
16 Maj*



*Vizite ne Qendren Dispecer
Kombetare "PJM" 14 Maj.*



Shkembim Pervoje me Rregullatorin e Washington D.C. 16 Maj.



*Takim me perfaqesues te
USAID-it dhe NARUK-ut,
Washington D.C. 15 Maj*

*Nga Nenshkrimi i Mareveshjes
se Bashkepunimit per Gazin
Natyror me Dr. e USAID-it
Z.Edward Landau*





Nga Takimi me Dr. e USAID-it Z.Edward Landau

Gjithashtu, ne mbeshtetje te VKM Nr. 27, date 19.01.2007 ” Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncensioneve”, ERE percaktoi cmimin prej 9.37 leke/kWh per shitjen e energjise nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 10 MW te dhene me koncension ne baze te Ligjit Nr, 9663 date 18.12.2006.

Nga monitorimi i vazhdueshem i veprimtarise se ketyre prodhuesve, ERE identifikoi nevojten per krijimin e kushteve sa me te favorshme per nxitjen e ndertimit te burimeve te reja apo rehabilitimit / zgjerimit te atyre ekzistuese. Ne kushtet kur vetem 33% e burimeve hidrike jane shfrytezuuar (qe do te thote mundesi konkrete per investime ne burime te reja), ERE ka pergjegjesine qe te kontribuojte drejtperdrejt ne krijimin e nje klime konkurrence per alternativat me te vlefshme te investimeve ne burimet ekzistuese dhe ato te reja te prodhimit te energjise elektrike. Ne zbatim te kesaj politike ERE licencensoi ne vitin 2008 tre shoqeri per ndertimin e kater HEC-eve (ne Tervol te Librazhdit, ne Bilisht, dhe ne Stranik dhe Zall Tore te Prenjasit), me fuqi te instaluar gjithesejt 15.05 MW. Keto HEC-e parashikohet te prodhojne 66.05 GWh energji elektrike ne vit dhe

te investojne rreth 10.4 Milion Euro.Ne punen e HEC-eve te vegjel eshte me rendesi te theksohet se disa prej tyre punojne ne menyre sezonale, mbasi uji perdoret edhe per ujitje te tokave bujqesore si dhe nga popullsia.

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI I LICENSUAR	DT. E LICENSIMIT	DT. E SKADIMIT	ASETET NE PERDORIM	SHENIM
KOMPANI PUBLIKE / PRODHIM						
01	KESH sha	Prodhim	Vendimi nr. 11 dt. 23/02/2006	23/02/2009	HC Fierze 500 MW HC Koman 600 MW HC V. Dejes 200 MW HC Ulez 24 MW HC Shkopet 25 MW HC Lanabregas 5 MW TC Fier 159 MW	
KONCESIONARE / PRODHIM						
01	EMIKEL 2003 sh.p.k	Prodhim	Vendimi nr. 6 dt. 16/02/2006	16/02/2034	HC Lenie 400 kW HC Çorovode 400 kW HC Tuçep 200 kW	
02	Albania Green Energy sh.p.k	Prodhim	Vendimi nr. 15 dt. 27/08/2003	27/08/2025	HC Smokthine 9 MW	
03	Balcan Green Energy shpk	Prodhim	Vendimi nr. 20 dt.19/12/2003	19/12/2033	25 HEC 8490 kW	Fiuqia e instaluar eshte dhene ne total
04	SPAHIU GJANÇ sh.p.k.	Prodhim	Vendimi nr. 20 dt.19/12/2003	19/12/2033	HC Gjanç 3700 kW	
05	WONDER POWER sha	Prodhim	Vendimi nr. 20 dt.19/12/2003	19/12/2033	HC Bogove 2500 kW	
06	AMAL sh.p.k	Prodhim	Vendimi nr. 18 dt.17/10/2003	17/10/2033	HC Xhyre 250 kW	

Tabela -1.6-(Burimi te dhenave nga METE)

07	HIDRO- INVEST 1 shpk	Prodhim	Vendim nr.113 dt. 24/09/2008	24/09/2038	HEC Stranik 1.6 MW HEC Zall Tore 2.6 MW	
PRIVATE / PRODHIM						
01	SAROLLI sh.p.k	Prodhim	Vendimi nr. 15 dt.27/08/2003	27/08/2033	HC Shpelle 117 kW	
02	Projeksion Energj sh.p.k.	Prodhim	Vendim nr. 15 dt.27/08/2003	27/08/2033	HC Rehove 100 kW HC Treska 1 130 kW HC Çarshove 70 kW	
03	DARDANIA ENERGJI sh.p.k	Prodhim	Vendimi nr. 20 dt.19/12/2003	19/12/2033	HC Bicaj 100 kW	Transferuar tek EN.KU shpk
04	MAKSI ELEKTRIK sh.p.k	Prodhim	Vendimi nr. 5 dt.11/01/2006	11/01/2034	HC Leskovik1 72 kW HC Leskovik2 100 kW	Transf nga KORSEL shpk
05	JUANA sh.p.k	Prodhim	Vendimi nr. 5 dt.12/03/2004	12/03/2034	HC Orenjë 75 kW	
06	WTS ENERGJI shpk	Prodhim	Vendimi nr. 39 dt.22/07/2004	22/07/2034	HC Tamarë 150 kW HC Selcë 75 kW HC Vukël 75 kW HC Vermosh 75 kW	
07	MARJAKAJ shpk	Prodhim	Vendimi nr. 43 dt.14/10/2004	14/10/2024	HC Benë 125 kW	
08	FAVINA 1 shpk	Prodhim	Vendimi nr. 85 dt.27/12/2005	27/12/2010	HC Vithkuq 780 kW	Transf nga FAVINA

III. ANALIZA E SEKTORIT TE GAZIT NATYROR NE SHQIPERI, VITI 2008.

3.1. Përgjegjësitë e ERE-s në Sektorin e Gazit Natyror.

Me Ligjin Nr.9946, datë 30.6.2008, “Për Sektorin e Gazit Natyror” hidhen bazat për krijimin e kuadrit rregullator në sektorin e gazit natyror në Shqipëri.

Nepermjet këtij ligji behet e mundur krijimi i një tregu konkurrues i gazit natyror si dhe integrimi i tij në tregjet rajonale dhe evropiane të gazit natyror.

Ky ligj krijon bazen e nevojshme legale për zbatimin e politikave, standardeve dhe procedurave për organizimin dhe rregullimin e tregut shqiptar të gazit natyror dhe aktiviteteve që lidhen me të.

Hartimi i ligjit është bërë duke u mbështetur në Direktivën 55/2003/EC të BE-së për gazin natyror si dhe në përvojën e disa vendeve të rajonit.

Sipas ligjit Nr.9946, datë 30.6.2008, “Për Sektorin e Gazit Natyror” ERE është përgjegjëse për licensimin e aktiviteteve të transmetimit, shpërndarjes, furnizimit, tregtimit, si dhe operimit të depozitave të gazit natyror të thatë dhe impianteve për gazin natyror. të lenget.

Krahas licensimeve, ERE gëzon autoritetin për vendosjen e tarifave për shërbimet në rrjetin e transmetimit, të shpërndarjes, të

depozitimit, te sherbimeve ndihmese dhe ballancimit si dhe tarifat e gazit per klientet fundore tarifore. Po ashtu ERE miraton edhe planin e investimeve te te licensuarve ne sektorin e gazit natyror.

Me rendesi jane edhe pergjegjesite qe ky ligj i ngarkon ERE-s lidhur me mbrojtjen e konsumatorit, monitorimin e te licensuarve per sigurine e furnizimit, detyrimet e sherbimit publik si dhe nje sere rregullash dhe procedurash qe se bashku me kodet e rrjetit dhe te matjes do te formojne kuadrin e pergjithshem rregullator ne sektorin e gazit natyror.

3.2. Sektori i Gazit Natyror ne Shqiperi.

Prodhimi i Gazit Natyror ka filluar ne vitin 1968 me Vendburimin e Divjakes me nje prodhim vjetor prej 70 miljon Nm³. Prodhimi pik i Gazit Natyror u arrit ne vitin 1982 me 0.937 miliard Nm³, me zbulimin e vendburimit te Cakranit. Ne dallim nga gazi natyror i Divjakes, gazi i Cakranit ishte gaz shoqerues i naftes, mbasi Cakrani ishte nje vendburim gaz-kondensati.

Numri i pergjithshem i puseve te gazit ne Shqiperi vleresohet me mbi 500 me nje prodhim kumulativ te gazit natyror prej 3.15 miliard Nm³, kurse prodhimi kumulativ i gazit shoqerues vleresohet me 8.7 miliard Nm³.

Mbas viteve 90 prodhimi i gazit natyror u reduktua ndjeshem duke arritur ne 12 milion Nm³ ne vit. Aktualisht numri i puseve prodhues te gazit natyror eshte zvogeluar ne rreth 20 dhe prodhimtaria e tyre eshte minimale (nga 300 ne 200 Nm³/dite).

Ne hartën e figures -3.1. - jane treguar vendburimet e gazit ne Shqiperi.

Deri ne vitin 1990 gazi natyror i prodhuar furnizonte industriale e plehrave kimike, idustrine e naftes dhe te energjise elektrike dhe shume pak sektorin rezidencial. Duke qene se vendburimet e gazit filluan te shteren, furnizimi me gaz natyror u reduktua gradualisht

dhe aktualisht prodhimi i gazit natyror dhe atij shoqerues shërben vetem për plotësimin e nevojave të industrisë së naftës.

Në grafikun e figurës -3.2 - është paraqitur ecuria e furnizimit të vendit me gaz për periudhën 1981 deri në vitin 1995.

Figura -3.1 –(Burimi METE)






Figura -3.2 –(Burimi nga METE)



Ne grafikun e figures – 3.3 - eshte paraqitur struktura e konsumit te gazit natyror.

Figura – 3.3. –(Burimi nga METE)



Per vleresimin e tregut te gazit natyror ne Shqiperi, qe nga viti 1994, jane kryer shume studime nga shoqeri ose institucione te njohura nderkombetare si “Partex”, “Sofregaz”, “Ruhrgas”, “Tenneco Gas”, “Banka Boterore” etj.

Nga keto studime ka rezultuar se konsumatoret kryesor te gazit natyror deri ne vitin 2015, parashikohet te jene: TEC-et me gaz, industria, sherbimet, turizmi dhe pjeserisht sektori rezidencial.

Tabela -3.1 -(Burimi nga METE)

Sektoret	Milion M3/vit	%
Gjenerim i energjise elektrike	724	60
Sektori industrial	81	7
Sektori i Sherbimeve	264	22
Ngrohja qendrore e banesave	104	9
Sektori rezidencial	32	2
Totali	1205	100

Ne tabelen - 3.1 - eshte paraqitur parashikimi i nevojave te vendit tone per gaz deri ne vitin 2015 sipas sektoreve perkates.

3.3. Lidhja e Shqiperise me Rrjetin Nderkombetar te Gazit.

Aktualisht Shqiperia, Kosova dhe Mali i Zi jane te vetmit shtete evropiane te cilet nuk jane te lidhur me rrjetet nderkombetare te gazit.

Ne kushtet aktuale, furnizimi i Shqiperise me gaz parashikohet te behet nepermjet lidhjes me rrjetet nderkombetare te gazit, per te cilat ekzistojne tre opsione:

- A- Si terminal fundor i gazedjellsave rajonal.
 - 1) Me gaz natyror rus nga Maqedonia
 - 2) Me gaz natyror rus nga Greqia

- B- Si tranzit i magjstralit te gazit per furnizimin e Evropes, neper-mjet Italise, me gaz natyror nga rajoni i Kaspikut, ne aksin Turqi - Greqi - Shqiperi - Itali, me anen e projektit “Transadriatik” ose ”TAP”.
- C- Si terminal i gazit natyror te lenget ne Bregdetin Adriatik

Ne Tregun Rajonal te Gazit, ne te cilin perfshihen vendet e Ballkanit Jug-perendimor, parashikimi i kerkese per gaz natyror deri ne vitin 2015, eshte paraqitur ne tabelen -3.2-

Tabela -3.2 –(Burimi nga METE)

Nr	Shteti	Kerkesa deri ne 2015 ne nm ³
1	Republika e Shqiperise	1205
2	Republika e Kosoves	560
3	Republika e Malit te Zi	701
4	Republikae Maqedonise	1020
5	Republika e Greqise	7300
6	Totali	10786

Nga analiza e projekteve te mundeshme te lidhjes se Shqiperise me rrjetin nderkombetar te gazit vleresohet me optimali projekti “TAP”. TAP do te kontribuojne ne diversifikimin dhe sigurine e furnizimit me gaz te vendeve te Evropes.

Ai vleresohet si projekti i gagesjellesit me eficient nga te 4 projektet e koridoreve te furnizimit te Evropes Juglindore. TAP perfshin opsionin e zhvillimit te depozitave (stokazheve) natyror te gazit ne Shqiperi, i cili vleresohet i rendesishem nga pikpamja e rritjes se sigurise se furnizimit me gaz.

Figura – 3.4 – (Burimi nga ERE)



Ne hartën e figures – 3.4. - është paraqitur gjurma e projektit të gazesjellesit "TAP". Karakteristikat themelore të këtij projekti janë si më poshtë:

Gjatesia Totale:	520 km.
Nga e cila:	185 km në Greqi. 200 km në Shqipëri. 115 km në Detin Adriatik
Diametri:	në tokë 48 inch (rreth 1.2 m). në det 36 inch.(rreth 0.91 m).
Kapaciteti:	10 miliard nm^3/vit , me zgjerim deri 20 miliard.
Lartësia më e madhe:	1,800 m.
Thellessia maksimale:	820 m.
Kostua e projektit:	1,500 milion Euro

Projekti TAP perfaqeson nje zgjidhje racionale dhe me impakt te rendesishem pozitiv per zhvillimin ekonomik te vendit tone. Ai perfaqeson nje projekt madhor ne infrastrukturen energjetike te Shqiperise dhe duke kontribuar ne rifutjen e perdorimit te gazit ne vendin tone ai kontribuon pervec te tjerash edhe ne rritjen e sigurise se furnizimit te vendit me energji.

Figura – 3.5 –(Burimi nga ERE)



Se fundi, duhet te theksojme se ky projekt duke pasur ne vetehte nje fleksibilitet te madh persa i perket kapacitetit transmetues, mbasi lejon dyfishimin e kapacitetit pa ndryshuar diametrin e tubacionit, por vetem nepermjet ndryshimit te parametrave te punes ben te mundur furnizimin me gaz edhe te Kosoves, Malit te Zi, Bosnje-Hezegovines dhe vendeve te tjera me ne veri te rajonit, nepermjet projektit te krijimit te nje unaze tubacionesh gazi qe do t’u sherbejne ketyre vendeve. Ne figuren – 3.5. - eshte treguar harta e zhvillimit te ketij projekti me kapacitet te dyfishuar.

3.4. Plani i veprimit per organizimin e veprimtarise se gazit natyror ne ERE.

Ne zbatim te Ligjit Nr.9946, date 30.6.2008, “Per Sektorin e Gazit Natyror”, neni 9, ERE pervec rolit si autoritet rregullator ne sektorin e energjise elektrike ngarkohet edhe si autoritet rregullator ne sektorin e gazit natyror, me perjashtim te veprimtarise se kerkimit dhe prodhimit te ketij gazi.

ERE ngarkohet gjithashtu nga ky ligj (neni 12), qe brenda 12 muajve nga data e hyrjes ne fuqi te tij, te miratoje legjislacionin sekondar te nevojshem per rregullimin ne veprimtarine e sektorit te gazit natyror ne Shqiperi.

Ne kuader te veprimtarise per rregullimin ne sektorin e gazit natyror me date 16 Prill 2008 Ministria e Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes ka neneshkruar nje Memorandum Mirekuptimi me USAID-in, nepermjet te cilit USAID-i merr persiper bashkepunimin per zbatimin e ligjit per gazin natyror si dhe hartimin e legjislacionit sekondar ne sektorin e gazit natyror.

Ne daten 27 Tetor 2008 perfaqesuesit e USAID-it i prezantuan ERE-s ekspertin e shoqerise konsulente amerikane qe do te asistojë ERE-n ne hartimin e te gjithë kuadrit rregullator ne sektorin e gazit natyror. Ne takimin e dates 30 Tetor konsulenti paraqiti nje draft te programit dhe tematikes qe do te trajtohet ne kuadrin rregullator te sektorit te gazit natyror.

Veprimtaria ne fushen e gazit natyror eshte nje veprimtari e re dhe e panjohur nga personeli ekzistues i ERE-s. Ndonese parimet e rregullimit kane karakter te pergjithshem, fusha ku do te zbatohen keto parime eshte krejtesisht e re, prandaj e vleresuem te domosdoshme, qe ERE te kompletohet me organiken e nevojshme per kete veprimtari.

Per te qene sa me racional ne konceptimin e struktures organizative dhe te numrit te punonjesve te ERE-s u arrit ne perfundimin,

qe duke ruajtur te njejten strukture organizative te miratuar nga Kuvendi i Shqiperise ne vitin 2008, te kerkojme vetem shtimin me 6 specialiste te organikes ekzistuese te ERE-s, dmth nga 32 punonjes gjithesej te miratohet organika e re me 38 punonjes, sipas organogrames te paraqitur ne aneksin “A2”.

Duke qene se afati i hartimit te legjislacionit sekondar nga ana e ERE-s, eshte i percaktuar me ligj, per respektimin e tij, dhe nje-kohesisht per te kryer edhe veprimtarine ne sektorin e gazit natyror sipas autoritetit qe na ngarkon ligji, ERE ju drejtua me nje kerkese Kuvendit te Shqiperise, ne daten 5 Nentor 2008 per miratimin e kesaj shtese ne organiken e ERE-s.

Krahas kesaj, ERE ju drejtua edhe Komisionit Perzgjedhes te Kuvendit te Shqiperise, per te emeruar sipas procedurave perkatese, antarin e Bordit te Komisionereve, i cili sipas ligjit Nr.9946, date 30.6.2008, “Per Sektorin e Gazit Natyror” duhet te jete specialist i fushes se hidrokarbureve.

Per fat te keq, deri ne fund te vitit 2008, kerkesa e ERE-s per nje shtese ne organike nuk u trajtuan nga ana e Kuvendit, ndersa kerkesa per caktimin e antarit te Bordit te Komisionereve u konkretizua me nje kandidature cilesore.

IV. ANALIZA E VEPRIMTARISE SE ENTIT RREGULLATOR TE SEKTORIT TE ENERGJISE GJATE VITIT 2008

4.1. Rregullimi i cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike.

Cmimet dhe tarifat e energjise elektrike perfaqesojne nje nga pergjegjesite kryesore te ERE-s dhe njekohesisht nje ceshtje me ndjeshmeri te larte per te gjitha opinionin publik, mbasi ato prekin financiarisht, sikurse ne te gjitha vendet e botes, te gjitha kategorite shoqerore te nje vendi.


Ne kuader global, energjia ne pergjithesi dhe energjia elektrike ne vecanti, po behen gjithnje e me te shtrenjta. Perqendrimi i burimeve te energjise fosile vetem ne disa vende prodhuese, dhe konsumi i tyre me ritme te larta nga i ter njerezimi, nga njera ane, dhe shterja e pritshme e ketyre burimeve nga ana tjetere e ka bere shume te mprehte raportin kerkese – oferte. Kjo situatë po shfrytëzohet aktualisht edhe me manifestimin e prirjeve per hegjemoni politike.

Nisur nga aspirata jone kombetare per integrim ne strukturat Euro-Atlantike e gjykojme te arsyeshme qe cmimet dhe tarifat e energjise elektrike ti trajtojme edhe ne sfondin e cmimeve dhe tarifave te vendeve te BE-se.

Ne grafikun e figures – 4.1. - jane paraqitur cmimet e energjise elektrike per klientet familjar te vendeve te BE-se per nje konsum


mujor prej 200 – 400 kWh (ose 2500 – 5000 kWh ne vit), per cdo familje. Karakteristike e tarifave te energjise elektrike ne keto vende eshte ndarja sipas nivelit te konsumit e klienteve familjar ne 5 grupe. Nga te dhenat e grafikut rezulton se tarifat me te uleta i ka Bullgaria me 7.21 Centeuero/kWh (9.3 lek/kWh) ndersa me te lartat Danimar-ka me 24.01 Centeuero/kWh (31.3 lek/kWh). Keto tarifa jane dhene duke perfshire TVSH-ne.

Figura - 4.1 –(Burimi nga Rap. Vjetor 2007 i Reg.Italian)



Edhe per klientet jo-familjare, tarifat e energjise elektrike jane ndare sipas nivelit te konsumit ne 6 blloqe. Ne grafikun e figures – 4.2 - jane paraqitur tarifat e energjise elektrike per klientet jo familjare te bllokut me konsum 500-2,000 MWh/vit ose rreth 42,000 – 1,700,000 kWh/muaj.

Figura – 4.2 – (Burimi nga Rap. Vjetor 2007 i Reg. Italian)



Nga te dhenat e ketij grafiku rezulton se tarifen me te ulet per fshire TVSH-ne, e ka Estonia, me 6.26 Eurocent/kWh (8.14 Lek/kWh) ndersa tarifen me te larte e ka Danimarka me 20.74 Eurocent/kWh (26.9 Lek/kWh). Ne te gjitha rastet konvertimi i monedhes eshte bere me kursin 1Euro = 130 Leke.

Nga shqyrtimi i te dhenave te mesiperme rezulton se tarifa mesatare e BE-se per klientet familjare eshte 16.36 Eurocent/kWh (21.26 Lek/kWh), ndaj tarifes prej 11.60 Eurocent/kWh (15.08 Lek/kWh) qe eshte per klientet jofamiljare. Sic konstatohet tarifa e klienteve familjare eshte rreth 41% me e larte se ajo e klienteve jofamiljare.

ERE ka percaktuar cmimet dhe tarifat e energjise elektrike dhe te sherbimeve ne sistemet e transmetimit dhe shperndarjes per vitin

2008 bazuar ne metodologjite perkatese te llogaritjes se tyre sipas parimeve te mbulimit te kostove te sherbimit qe shkaktohen nga cdo grup klientesh ne çdo nivel tensioni ku ofrohen sherbimet e energjise elektrike, duke dhene sinjalet e duhura per perdorimin me eficence te energjise elektrike nga klientet tarifore dhe duke eleminuar nder-subvencionet ndermjet grupeve te klienteve, me qellim qe shoqeria te siguroje vazhdimesine e aktivitetit duke realizuar norme te arsyeshme fitimi. Tarifat dhe çmimet e vendosura i jane nenshtruar nje procesi transparent dhe te drejte me te gjitha grupet e interesit ne cdo rast te rishikimit te tyre.

Tarifat dhe çmimet e vendosura kane tentuar te sigurojne nxitjen e investimeve ne sektorin e prodhimit te energjise elektrike, per te siguruar ne te ardhmen nje furnizim te sigurte dhe te qendrueshem me energji elektrike.

Mbeshtetur ne keto parime, ERE miratoi gjate vitit 2008 cmimet dhe tarifat per çdo sherbim te energjise elektrike, si me poshte:

Me vendimin Nr. 22, date 14.02.2008 “Per percaktimin e cmimit te shitjes se energjise elektrike per te licensuarit per prodhimin e energjise elektrike nga hidrocentralet me fuqi te instaluar deri ne 10 MW per periudhen 1 Mars 2008 - 28 Shkurt 2009” dhe eshte percaktuar çmimi = 6.50 leke/kWh;

Me vendimin Nr. 82, date 24.12. 2007 “Per percaktimin e çmimit te shitjes se energjise elektrike nga HEC-et e rinj me fuqi te instaluar deri ne 10 MW per vitin 2008” dhe eshte percaktuar cmimi = 9.37 leke/kWh;

Me vendimin Nr. 18, date 14.02. 2008 “Per percaktimin e tarifes se prodhimit te energjise elektrike nga KESH sha per periudhen 1 Mars 2008 – 28 Shkurt 2009” dhe eshte percaktuar tarifa e prodhimit 0.78 leke/kWh;

Me vendimin Nr. 75, date 26.06.2008 “Per percaktimin e çmimit te shitjes me shumice te energjise elektrike nga FPSH per periudhen 1 Korrik 2008 – 28 Shkurt 2009” dhe eshte percaktuar tarifa e shitjes me shumice te energjise elektrike 1.61 leke/kWh.

Me vendimin Nr. 19, date 14.02. 2008 “Per percaktimin e tarifes se sherbimit te transmetimit te energjise elektrike nga OST sh.a per periudhen 1 Mars 2008 – 28 Shkurt 2009” dhe eshte percaktuar tarifa e sherbimit te transmetimit 0.50 leke/kWh;

Me vendimin Nr. 20, date 14. 02. 2008 “Per percaktimin e tarifes se sherbimit te shperndarjes se energjise elektrike per perdoruesit e sistemit te shpendarjes, per periudhen 1 Mars 2008 - 28 Shkurt 2009” dhe jane percaktuar tarifat e sherbimit te shperndarjes 2.00 leke/kWh per perdoruesit ne 35 kV dhe 2.60 leke/kWh per perdoruesit ne 20/10/6 kV;

Me vendimin Nr. 21, date 14.02. 2008 “Per percaktimin e çmimit te shitjes me pakice per konsumatorët tarifore per periudhen 1 Mars 2008 - 28 Shkurt 2009”, u percaktuan çmimet sipas tabelës - 4.1 -

Ne zbatimin e metodologjise se cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike, per here te pare, ne vendosjen e tyre gjate vitit 2008, u moren per baze disa parime te rendesishem te cilet e modernizojne procesin ne perputhje me principet qe perdoren nga vendet e BE-se.

Tabela – 4.1 - (Burimi nga ERE)

Çmimet e shitjes me pakice të energjisë elektrike për konsumatorët tarifore, të miratuara nga ERE për periudhën 01 Mars 2008 - 28 Shkurt 2009.

Niveli i Tensionit	Kategoritë e Konsumatoreve	Çmimi (leke/kWh)	Çmimi i energjisë reaktive leke/kVAr	Çmimi i energjisë në pik (leke/kWh)
TENSIONI I LARTË	Kliente të Transmetimit TL me asete të zotuar prej tyre			
	Industri	5.20	0.78	9.00
	Tregeti & shërbime			
	Bujqësi			
	Te tjere			
	Kliente të furnizuar në N/S 110 kV të shpërndarjes			
	Industri	7.00	1.05	9.64
	Tregeti & shërbime	7.00	1.05	9.64
	Bujqësi	7.00	1.05	9.64
	Te tjere	7.00	1.05	9.64
TENSIONI I MESEMI	Kliente të furnizuar në 35 kV			
	Industri	7.50	1.13	10.00
	Tregeti & shërbime	7.50	1.13	10.00
	Bujqësi	7.50	1.13	10.00
	Te tjere	7.50	1.13	10.00
	Kliente të furnizuar në 20/10/6 kV			
	Industri	8.00	1.20	11.00
	Tregeti & shërbime	8.50	1.20	11.00
	Furra buke, prodhim mielli	7.00	1.05	11.00
	Bujqësi	8.00	1.20	11.00
Te tjere	8.00	1.20	11.00	
Buxhetore	9.50	1.41	11.00	
TENSIONI I ULËT	Kliente të furnizuar në TU			
	Industri	9.50		
	Tregeti & shërbime	10.00		
	Furra buke, prodhim mielli	7.50		
	Bujqësi	9.50		
	Te tjere	10.00		
	Buxhetore	12.00		
	Bloku I për deri në 300 kWh	7.00		
	Bloku I dytë mbi 300 kWh	12.00		
	Tarifa fikse e shërbimit për leximin "zero" (leke/muaj)	200		
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (shkalle, pompe, ashensor, etj (leke/kWh)	7.0			
TOTAL	8.45			

Shënim: Orari gjatë të cilit do të aplikohet tarifa për energjinë e konsumuar në pik është:

Për periudhën 1 Nëntor - 31 Mars
Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor

4.1.1. Tarifa per kapacitet dhe per energji.

Deri me sot ne metodologjine e caktimit te cmimeve te energjise elektrike tarifa e energjise per kapacitet ka qene e fshehur ne tarifen per energji dhe e shperndare uniformisht te te gjithë klientet pavaresisht kapacitetit te ngarkeses se tyre.

Nje shperndarje e tille krijon nje menyre specifike ndersubvencionimi ndermjet klienteve me kapacitet te ndryshem dhe per pasoje mungon transparenca mbi shperndarjen e kostove te klientet. Ne praktiken nderkombetare, ne pergjithesi, tarifat per kapacitet dhe per energji llogariten te ndara, por ato mund te llogariten edhe me nje tarife te vetme, si mesatare e te djave.

Kapaciteteve te ndryshme te klienteve i pergjigjen nivele te ndryshme investimesh dhe sherbimesh nga ana e sistemit elektroenergjetik, per te garantuar furnizimin e tyre me energji elektrike, per pasoje kapacitetet e ndryshme do te kene tarife kapaciteti te ndryshem pavaresisht nga sasia e energjise qe konsumojne. Ndersa tarifa per energji varet nga mbulimi i kostove te furnizimit me energji ne nivele te ndryshme tensioni.

Duke u nisur nga keto konsiderata ERE aplikoi parimin e tarifave te vecanta per kapacitet dhe per energji te shprehura si mesatare e te djave ne tarifat e energjise elektrike per vitin 2008.

Metodologjija e vleresimit te tarifes per kapacitet u mbeshtet ne vleresimin e koeficienteve te ngarkeses per cdo grup te klienteve sipas niveleve te sherbimit, duke shfrytezuar per kete qellim grafiket tip te ngarkeses te grupit perkates.

4.1.2. Parimi i tarifave sipas nivelit te sherbimit per cdo grup konsumatoresh.

Klientet e energjise elektrike te lidhur ne sistemin elektroenergjetik ne nivele te ndryshme tensioni karakterizohen nga nivele

te ndryshme kostoje sherbimi. Per rrjedhoje, ne perputhje me metodologjine e caktimit te cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike, duke u mbeshtetur ne parimin e kostos reale te sherbimit per cdo grup te konsumatoreve ne nivele te ndryshme tensioni u vendosen nivele te ndryshme cmimesh e tarifash.

ERE ne vleresimin e tarifave ka marre ne konsiderate parimin e caktimit te tarifave te energjise elektrike sipas nivelit te tensionit ku furnizohet cdo grup i klienteve, duke shmangur ne kete menyre ndersubvencionimin midis kategorive te klienteve.

4.1.3. Parimi i ndarjes se tarifave sipas llojit te sherbimit.

Ne kuadrin e ndarjes se KESH-it nga nje korporate vertikalisht e integruar, ne disa shoqeri juridikisht, financiarisht dhe organizativisht te ndara, ERE ne metodologjine e caktimit te cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike mori ne konsiderate parimin e ndarjes se tarifave per sherbimet e gjenerimt, transmetimit, shperndarjes dhe furnizimit.

ERE duke vepruar ne kete menyre, i hapi rruge nepermjet sistemit tarifar procesit te privatizimit te sherbimeve te shperndarjes dhe furnizimit me pakice me energji elektrike.

4.1.4. Parimi i tarifave te energjise elektrike me dy blloqe.

ERE e gjykoi te nevojshme, qe per kushtet specifike te vendit tone, ku ngrohja me energji elektrike vazhdon te perbeje rreth 35 % te konsumit te pergjithshem familjar, te aplikojte tarifa te diferencuara per dy blloqe me konsum te diferencuar, ne menyre qe nepermjet mekanizmit te cmimeve te dekurajoje perdorimin e energjise elektrike per ngrohje nga ana e klienteve familjare.

Nevojat per gatim, dhe vecanerisht per ngrohje te baneses, duke qene se ne treg ekzistojne te gjitha mundesite qe ato te plotesohen

edhe me lende te tjera energjetike, me te njejtin efektivitet dhe komfort sikurse me energji elektrike, dhe per disa prej tyre me cmim me te lire, nuk jane konsideruar si nevoja te rendesise se pare nga pikpamja e perdorimit te energjise elektrike.

Nisur nga ky arsyetim, per klientet familjare me konsum deri ne 300 kWh ne muaj, u vendos cmimi i energjise elektrike 7 Lek/kWh, dhe kjo kategori konsumatoresh u quajt kategori e bllokut te pare. Per konsum mbi 300 kWh u vendos tarifa 12 Lek/kWh.

Aplikimi i tarifave te diferencuara per blloqet, ka sherbyer si nje instrument qe nxit perdorimin e gazit te lenget dhe lendeve te tjera energjetike alternative per gatim, ngrohje banese, etj. Gjithashtu nje parim i tille ka nxitur edhe perdorimin me eficience te energjise elektrike nga familjaret.

4.1.5. Parimi i tarifes "pik" dhe "jashte pikut".

Grafiket e ngarkeses te sistemit elektro-energjetik, qe shprehin madhesine e ngarkeses elektrike ne cdo moment te dites 24 oreshe karakterizohen nga ngarkesa maksimale ose ngarkesa pik ne ore te caktuara te dites.

Piku i ngarkeses e rrit ne menyre te theksuar ngarkesen nga kushte rastesore. Ne rastin konkret ngarkesa maksimale e pikut 1370 MW ndaj ngarkeses mesatare 800 MW rezulton 1.71 here me e larte.

Per te mbuluar ngarkesen e pikut rriten shume investimet per gjenerim ose per import te energjise elektrike si dhe investimet ne te gjithë elementet e sistemit te transmetimit dhe te shperndarjes dhe zvogelohet ne kete menyre eficiencia e sistemit energjetik ne teresi.

Eshte kjo arsyeja, qe ERE mori ne konsiderate tarifimin e energjise elektrike ne oret e pikut ne menyre te diferencuar nga energjia jashte oreve te pikut per klientet industriale ne tension te mesem dhe te larte. Ne tabelen -8- jane paraqitur tarifat e energjise elektrike per periudhen e pikut.

Duke rritur tarifen e energjise elektrike ne oret e pikut, kundrejt asaj jashte pikut, nxitet tek konsumatori, per efekt te leverdishmerise ekonomike, modifikimi i grafikut individual te ngarkeses ne menyre qe konsumi ne oret e pikut te reduktohet sa me shume.

4.1.6. Parimi i tarifes se Sherbimit per leximin zero.

Ne cdo vend, sistemet elektro-energjetike perkatese kryejne shpenzime te konsiderueshme per te mbajtur sistemin ne gatishmeri dhe per te ofruar ne cdo moment furnizim me energji elektrike. Pervec kesaj, pavaresisht ne se konsumohet ose jo energji elektrike, KESH-i kryen shpenzime per sherbimin e leximit te matsave, pergatitjes se faturave te konsumit te energjise elektrike dhe shperndarjes se tyre te cdo konsumator.

Ky sherbim kryhet ne menyre te barabarte si per konsumatoret qe konsumojne energji elektrike ashtu edhe per ata qe nuk konsumojne energji elektrike ose sic thuhet kane fature me lexim zero.

Ne se te konsumatoret qe kane konsum te energjise elektrike, tarifa e sherbimit eshte e perfshire ne koston e energjise elektrike, per konsumatoret qe nuk konsumojne energji elektrike ose jane me lexim zero nuk ekziston aktualisht asnje detyrim ndaj sherbimit te furnizimit me energji elektrike ndonse ai kryhet edhe per ta.

Nisur nga keto konsiderata ERE ne cmimet dhe tarifat e vitit 2008 e gjykoi te arsyeshme dhe te nevojshme aplikimin e tarifes se sherbimit per konsumatoret me lexim zero te matesit, ne masen 200 lek/muaj.

4.1.7. Parimi i marredhenieve te tarifave familjare-industri.

Nje tipar me rendesi ne kriteret per vendosjen e cmimeve dhe tarifave te energjise elektrike per vitin 2008, ka qene edhe ai qe ka te beje me raportet e tarifave ndermjet konsumatoreve familjare dhe konsumatoreve te industrise.

Ne ekonomite e centralizuara shteterore ku i gjithë zhvillimi ekonomik i vendit behet vetem me pjesmarjen e shtetit dhe ku mungon konkurrenca e lire, karakteristike kjo e regjimeve totalitare, edhe cmimet e energjise elektrike per popullaten sikurse cmimet e tjera te konsumit kane karakter populist. Ne ekonomite e tregut te lire ku ekziston liberalizimi i tregut dhe cmimet i neneshtrihen ligjeve te kerkese-ofertes dhe kostove te sherbimit, konsumatorët familjare jane pjese e tregut me pakice qe furnizohen ne rrjetin e tensionit te ulet. Kjo perben arsyen kryesore pse cmimet e energjise elektrike per kete kategori konsumatoresh do te jene me te larta se ato te industrise e cila furnizohet ne rrjetin shperndares te tensionit te mesem ose ne rrjetin e transmetimit ose te tensionit te larte. Nga ana tjetër biznesi ne pergjithesi dhe industria ne vecanti jane forca levizese e zhvillimit qe percaktojne edhe rritjen ekonomike te nje vendi dhe per pasoje politikat nxitese ndaj tij shprehen edhe ne politiken e cmimeve te energjise elektrike. Ne vendet post-totalitare cmimet e biznesit jane me te larta se ato te familjareve. Por per vendet ne tranzicion drejt ekonomise se tregut te lire politikat e cmimeve duhet te kene per tendence pikerisht konsideratat qe u paraqiten me siper. Kjo tendence eshte ruajtur edhe nga ERE ne vendosjen e cmimeve dhe tarifave per vitin 2008.

4.2. Veprimtaria e Sektorit te Licensimit te ERE-s.

Gjate vitit 2008 Sektori i Licensimit ne Drejtorine e Licensave dhe Monitorimit te Tregut ka ndjekur dhe trajtuar 27 aplikime per:

- licensim ne aktivitetet e sektorit te energjise elektrike;
- modifikimin e licensave ekzistuese;
- rinovimin e licensave si dhe
- kualifikimin e impianteve si prodhues te energjise se rinovueshme.

Ne total gjate vitit 2008 licensimet qe jane kryer sipas veprimtarive te pershkruara me larte, paraqiten ne tabelen – 4.2 -

Tabela – 4.2 – (Burimi nga ERE)

Aktiviteti	Nr. i licensave
Ndertimi/Prodhimi	9
Prodhim	1
Shperndarje	1
Furnizimi publik me shumice	1
Furnizimi publik me pakice	1
Furnizues i Kualifikuar	2
Tregtimi	2
Modifikim i licensave ekzistuese	4
Rinovim	1
Kualifikim i impianteve si burime te rinovueshme energjie	5

Ne vijim jepet tabela -4.3 -, e cila eshte nje table permbledhese me te gjitha karakteristikat perkatese te shoqerive te licensuara.

Ne vecanti mund te permendet licensimi i disa impinatve te reja prodhuese (parqe eolike, HEC dhe TEC me biomase). Ne vijim jepet nje table permbledhese me te dhenat kryesore per sa i perket fuqise se instaluar prodhimit te energjise dhe vleres se investimit.

Ne vijim jepet tabela -4.4 - e cila eshte nje table permbledhese me subjektet e licensuar si dhe tabela e impianteve te kualifikuar si prodhues te energjise se rinovueshme

Se fundi theksojme se me amendimin qe ju be ligjit nr.9072 date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike” me ane te ligjit Nr.9913, date 5.5.2008, ne nenin 34/1, pika 1, te ketij ligji thuhet : “Ndertimi i burimeve te reja gjeneruese, kur nuk eshte miratuar me nje kontrate koncensionare, behet me miratimin e Keshillit te Ministrave”.

Po ashtu sipas po ketij ligji, ne nenin 13 pika 1.a. thuhet se ERE leshon license per prodhimin e energjise elektrike, ne dallim nga ligji para amendimit, ku ERE kishte autoritetin te leshonte license per

ndertimin, shfrytezimin dhe prodhimin e energjise elektrike. Ne per-
 uthje me kerkesat e ketij ligji, nga ana e ERE-s u bene reflektimet
 perkatese ne procedurat dhe tipin e licences.

Tabela -4.3 –(Burimi nga ERE)

Nr	Emri i Kompanise	Aktiviteti	Nr. Vendimi i ERE
1	Enpower Albania shpk	Licensim/Park Eolik	Nr.110 dt.16.09.2008, Nr.122 dt.10.10.2008
2	ACR Energy shpk	Licensim/Furnizues i Kualifikuar	Nr.28 dt.04.03.2008
3	OSSH sha	Licensim/Shperndarje, Furnizim, Import	Nr.8,9,10 dt.25.01.2008
4	Enpower Albania shpk	Kualifikim RES	Nr.5 dt.17.01.2008
5	KESH sha	Rinovim/Importi/Eksporti	Nr.26,27 dt.22.02.2008
6	Albanian Green Energy shpk	Kualifikim RES	Nr.23 dt.22.02.2008
7	Biopower Green Energy shpk	Kualifikim RES	Nr.24 dt.22.02.2008
8	Projeksion Energji sha	Modifikim license	Nr.47 dt.18.04.2008
9	Ers-08 shpk	Licensim/Park Eolik	Nr.63 dt.13.06.2008
10	HERA shpk	Kualifikim RES	Nr.48 dt.18.04.2008
11	HEC Tervoli shpk	Licensim/HEC	Nr.57 dt.02.06.2008
12	En.Ku shpk	Modifikim license	Nr.86 dt.17.07.2008
13	MUSO HC Qyteze shpk	Licensim/HEC	Nr.91 dt.06.08.2008
14	E-VENTO S.R.L,ALBANIA shpk	Licensim/Park Eolik	Nr.84 dt.17.07.2008
15	Albanian Green Energy shpk	Licensim/TEC Biomase	Nr.89 dt.06.08.2008
16	Biopower Green Energy shpk	Licensim/Park Eolik	Nr.90 dt.06.08.2008
17	Unione Eolika Albania shpk	Licensim/Park Eolik	Nr.88 dt.06.08.2008
18	UNIVERSI shpk	Licensim/Tregtues	Nr.119 dt.09.10.2008
19	Hidroinvest 1 shpk	Licensim/ HEC	Nr.113 dt.24.09.2008
20	GEN-I Tirana shpk	Licensim/Furnizues i Kualifikuar	Nr.129 dt.02.12.2008
21	GEN-I Tirana shpk	Licensim/Tregtues	Nr.130 dt.02.12.2008
22	Enpower Albania shpk	Licensim/Tregtues	Ne proces
23	Unione Eolika Albania shpk	Kualifikim RES	Nr. 132 dt.09.12.2008
24	TERMOCENTRALI Vlore sha	Licensim/TEC	Ne proces

Tabela 4.4 –Burimi ERE

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI I LICENSUAR	DT. E LICENSIMIT	DT. E SKADIMIT	ASETET NE PERDORIM	SHENIM
KOMPANI PUBLIKE / PRODHIM						
01	KESH sha	Prodhim	Vendimi nr. 11 dt. 23/02/2006	23/02/2009	HC Fierze 500 MW HC Koman 600 MW HC V. Dejes 200 MW HC Ulez 24 MW HC Shkopet 25 MW HC Lanabregas 5 MW TC Fier 159 MW	
KONCESIONARE / PRODHIM						
01	EMIKEL 2003 sh.p.k	Prodhim	Vendimi nr. 6 dt. 16/02/2006	16/02/2034	HC Lenie 400 kW HC Çorovode 400 kW HC Tuçep 200 kW	
02	Albania Green Energy sh.p.k	Prodhim	Vendimi nr. 15 dt. 27/08/2003	27/08/2025	HC Smokthine 9 MW	
03	Balcan Green Energy shpk	Prodhim	Vendimi nr. 20 dt.19/12/2003	19/12/2033	25 HEC 8490 kW	Fiuqia e instaluar eshte dhene ne total
04	SPAHIU GJANÇ sh.p.k.	Prodhim	Vendimi nr. 20 dt.19/12/2003	19/12/2033	HC Gjanç 3700 kW	
05	WONDER POWER sha	Prodhim	Vendimi nr. 20 dt.19/12/2003	19/12/2033	HC Bogove 2500 kW	
06	AMAL sh.p.k	Prodhim	Vendimi nr. 18 dt.17/10/2003	17/10/2033	HC Xhyre 250 kW	
07	HIDRO- INVEST 1 shpk	Prodhim	Vendim nr.113 dt. 24/09/2008	24/09/2038	HEC Stranik 1.6 MW HEC Zall Tore 2.6 MW	
PRIVATE / PRODHIM						
01	SAROLLI sh.p.k	Prodhim	Vendimi nr. 15 dt.27/08/2003	27/08/2033	HC Shpelle 117 kW	

02	Projeksion Energji sh.p.k.	Prodhim	Vendim nr. 15 dt.27/08/2003	27/08/2033	HC Rehove 100 kW HC Treska 1 130 kW HC Çarshove 70 kW	
03	DARDANIA ENERGJI sh.p.k	Prodhim	Vendimi nr. 20 dt.19/12/2003	19/12/2033	HC Bicaj 100 kW	Transferuar tek EN.KU shpk
04	MAKSI ELEKTRIK sh.p.k	Prodhim	Vendimi nr. 5 dt.11/01/2006	11/01/2034	HC Leskovik1 72 kW HC Leskovik2 100 kW	Transferuar nga KORSEL shpk per efekt te ndarjes se llogarive financiare
05	JUANA sh.p.k	Prodhim	Vendimi nr. 5 dt.12/03/2004	12/03/2034	HC Orenjë 75 kW	
06	WTS ENERGJI shpk	Prodhim	Vendimi nr. 39 dt.22/07/2004	22/07/2034	HC Tamarë 150 kW HC Selcë 75 kW HC Vukël 75 kW HC Vermosh 75 kW	
07	MARJAKAJ shpk	Prodhim	Vendimi nr. 43 dt.14/10/2004	14/10/2024	HC Benë 125 kW	
08	FAVINA 1 shpk	Prodhim	Vendimi nr. 85 dt.27/12/2005	27/12/2010	HC Vithkuq 780 kW	Transferuar nga FAVINA shpk per efekt te ndarjes se llogarive financiare
NDERTIM, INSTALIM DHE PRODHIM						
01	Energjo – Sas shpk	Ndertim Prodhim HEC	Vendim nr. 83 dt.27/11/2006	27/11/2036	HC Sasaj 7MW	
02	REMI shpk	Ndertim Prodhim HEC	Vendimi nr.57 dt. 11/10/2007	11/10/2037	HC Egnatia 5 MW	Kushtet e vendimit
03	Hera shpk	Ndertim Prodhim Park Eolik	Vendim nr.61 dt. 02/11/2007	02/11/2037	Projekti Kappet 150 MW (eolike)	Kushtet e vendimit
04	Alb Wind Energy shpk	Ndertim Prodhim Park Eolik	Vendimi nr.13 dt. 28/01/2008	28/01/2038	Grykderdhja e Shkumbinit, Terpan 225 MW	Kushtet e vendimit

05	ERS-08 shpk	Ndetim Prodhim Park Eolik	Vendimi nr.63 dt. 13/06/2008	13/06/2038	Kavaje, Kryevidh 40 MW	Kushtet e vendimit
06	Biopower Green Energy shpk	Ndetim Prodhim Park Eolik	Vendimi nr.90 dt. 06/08/2008	06/08/2038	BPGE 1, BPGE 2 Lezhe 230 MW	Kushtet e vendimit
07	Union Eolica Albania shpk	Ndetim Prodhim Park Eolik	Vendimi nr.88 dt. 06/08/2008	06/08/2038	Kryevidh, Kavaje 150 MW	Kushtet e vendimit
08	E-Vento srl Albania shpk	Ndetim Prodhim Park Eolik	Vendimi nr.84 dt. 17/07/2008	17/07/2038	Butrint, Markat 72 MW	Kushtet e vendimit
09	Enpower Albania shpk	Ndetim Prodhim Park Eolik	Vendimi nr.110 dt. 16/09/2008 Vendimi nr.122 dt. 10/10/2008	16/09/2038	Karaburun Llogara 500 MW	Kushtet e vendimit
10	Albanian Green Energy shpk	Ndetim prodhim TEC me biomase	Vendimi nr.89 dt. 06/08/2008	06/08/2038	Lezhe 140 MW	Kushtet e vendimit
11	HEC Tervoli shpk	Ndetim Prodhim HEC	Vendimi nr.57 dt.02/06/2008	02/06/2038	Librazhd 10.6 MW	
12	Muso HEC Qyteze shpk	Ndetim Prodhim HEC	Vendimi nr.91 dt. 06/08/2008	06/08/2038	Devoll 250 kW	
TRANSMETIMI						
01	OST sha	Transmetim	Vendimi nr. 14 dt.03/03/2006	03/03/2009	Rjeti i transmetimit ne RSH Distriktet: Fier, Burrel, Tirane, Elbasan, RMU Sarande	
SHPERNDARJA/FURNIZIMI						
01	OSSH sha	Shperndarje	Vendimi nr. 8 dt. 25/01/2008 Vendimi nr.114 dt.01/10/2008	25/01/2038	Rjeti i shperndarjes ne RSH Distriktet: Fier, Burrel, Tirane, Elbasan, RMU Sarande	
02	OSSH sha	Furnizim public me pakice	Vendimi nr. 09 dt. 25/01/2008 Vendimi nr.58 dt.03/06/2008	25/01/2013	Furnizimi i te gjithë klienteve tarifore ne RSH ne cdo nivel tensioni	
03	GSA shpk	Furnizues i kualifikuar	Vendim nr. 2 dt.25/01/2005	25/01/2010		

04	ACR Energy shpk	Furnizues i kualifikuar	Vendimi nr.28 dt. 04/03/2008	04/03/2013		
05	KESH sha	Furnizuesi public me shumice	Vendimi nr.11 dt. 23/02/2006 Vendimi nr.59 dt. 03/06/2008	23/02/2011		
06	GEN - I TIRANA shpk	Furnizues i kualifikuar	Vendimi nr.129 dt 02/12/2008	02/12/2013		
TREGETIMI						
01	GSA shpk	Tregtim	Vendimi nr. 79 dt.21/12/2007 Vendimi nr.116 dt. 01/10/2008	26/01/2011		
02	SPAHIU GJANC shpk	Tregtim	Vendim nr. 34 dt. 08/06/2007 Vendimi nr. 35 dt. 08/06/2007 Vendimi nr.116 dt. 01/10/2008	07/06/2010		
03	UNIVERSI shpk	Tregtim	Vendimi nr.113 dt. 24/09/2008	24/09/2013		
04	GEN - I TIRANA shpk	Tregtim	Vendimi nr.130 dt 02/12/2008	02/12/2013		

4.3. Veprimtaria monitoruese e ERE-s.

Nje nga arritjet e rendesishme te ERE-s gjate vitit 2008 eshte institucionalizimi i monitorimit te tregut dhe te licensuarve ne sektorin e energjise elektrike, nepermjet strukturave te specializuara monitoruese te cilat filluan funksionimin ne Qershor 2008 ne perputhje me strukturen e re te ERE-s te miratuar nga Kuvendi.

Monitorimet jane kryer sipas nje plani tematik paraprak dhe ne fokus kan qene ne radhe te pare strukturat e OSSH-es,

Ne tabelen - 4.5 - jane paraqitur monitorimet kryesore te zhvilluara deri ne fund te vitit 2008.

Qellimi kryesor i programit te monitorimeve ishte kontrolli i zbatimit të kuadrit ligjor dhe standarteve te sherbimit ndaj konsumatorit ne te gjitha aspektet e furnizimit me energji elektrike. Nepermjet monitorimit ERE u njoh drejtpersedrejti me gjendjen reale te sherbimit

te shperndarjes ne zonat e OSSHes si dhe te subjekteve te tjere te monitoruar. Nepermjet analizes se te dhenave te grumbulluara u evidentuan per cdo zone ne vecanti dhe per OSSH-en ne teresi problemet dhe te metat qe i karakterizojne ata ne punen e tyre. Ne kete kuader ERE percaktoi detyrat dhe rekomandimet qe keto subjekte duhet te permbushin ne menyre qe te permiresohet puna ne te ardhmen.

Gjate procesit te monitorimit te zonave te OSSH-es u evidentuan nje radhe te metash te cilat ne menyrete permbledhur paraqiten me poshte:

Raportimi periodik i detyrueshem nga OSSH-ja ne ERE nuk paraqitet i plote dhe duke respektuar afatet e percaktuara. Shpesh ka mosperputhje te te dhenave te raportuara ne ERE me ato qe merren direkt ne zona. Shpesh nuk ka rakordim ndermjet sektorit teknik dhe atij te faturimit.

Pervec mospajisjes me matsa te nje numri te konsiderueshem abonentesh, nuk jane te pajisura me matsa pjesa me e madhe e kabineve te transformacionit cka pengon bilancin e energjise ne baze dalje te T.U. Po ashtu nuk jane instaluar matsa per energjine rreaktive dhe energjine e pikut

Labororet e kolaudimit te matsave ne pjesen me te madhe jane ne gjendje jo te pershtateshme persa i perket standarteve qe duhet te plotesojne dhe nga ana e tyre nuk behet kontrolli periodik i planifikuar i matsave.

Faturat e energjise elektrike ne shume raste nuk respektojne leximin periodik 1 mujor por permbajne lexime mbi 1mujore, faturimi i energjise qe kosumohet nga strukturat e kompanise nuk behet sipas tarifes per jo buxhetoret por me nje cmim te pamiratur nga ERE. Disa here jane verejtur faturime me vlera jo reale qe demtojne konsumatorin.

Tabela – 4.5 – (Burimi nga ERE)

Emertimi	Periudha	Objekti i monitorimit
Monitorim i veprimtarisë së KESH-GEN sha dhe OST sha	Korrik 2008	<ul style="list-style-type: none"> Kontratat e importit dhe shkëmbimit të energjisë elektrike për vitin 2008. Programet e shfrytëzimit të kaskadës së lumit Drin e të prodhimit të energjisë për vitin 2008. Zbatimi i kushteve të licencës së prodhimit dhe transmetimit për vitin 2008
Monitorimin e subjekteve “ALBWIND” “HERA” (energji elektrik)	Korrik 2008	<ul style="list-style-type: none"> Zbatim i kushteve të licencës Ecuria e investimeve Monitorim i rezultateve paraprake të studimit të fizibilitetit
Monitorim i veprimtarisë së OSSH-sha (Ballafaqim informacionesh)	Ko-Dhjetor 2008	<ul style="list-style-type: none"> Studim paraprak i raportimeve për zonat e programuara për tu monitoruar Verifikimi i të dhënave të nxjerra nga monitorimi i zonave të programuara. Diskutim me sektore të ndryshme për problematikat e hasura në zonat e OSSH-se.
Monitorim i OSSH –se zona Fier	Gusht 2008	<ul style="list-style-type: none"> Monitorim i aktivitetit të shpërndarjes për vitin 2007 Monitorim i aktivitetit të shpërndarjes nga fillimi i vitit 2008 Monitorim i shitjeve dhe gjendja e debive. Kontrolli i rregullsisë së faturimit sipas fashave të cmimeve dhe tensioneve. Defektet gjatë vitit 2008 (raportimet) Nderprerjet e programuara gjatë vitit 2008 Ecuria e vendosjes së matësve dhe zvoqlimit të abonenteve pa matje. Realizimi i investimeve plan për vitin e verifikimi i zbatimit të tyre. Lidhjet e reja dhe zbatimi i rregulloreve në fuqi.
Monitorim i OSSH –se zona Burrel	Shtator 2008	
Monitorim i OSSH –se zona Shkoder	Tetor 2008	
Monitorim i OSSH –se zona Korce	Nëntor 2008	
Monitorim i OSSH –se zona Gjirokastrë	Dhjetor 2008	

4.4. Hartimi dhe perpunimi i legjislacionit sekondar ne ERE.

Ne veprimtarine e ERE-s nje vend me rendesi ze hartimi apo perpunimi i legjislacionit sekondar ne sektorin e energjise sipas kerkesave te Ligjit nr.9072 date 22.05.2003 “ Per Sektorin e Energjise Elektrike”, Ligjit nr.9946, date 30.06.2008, “Per Sektorin e Gazit Natyror” dhe akteteve te tjera nenligjore ne fuqi.

Per te perftuar nga pervoja e vendeve te tjera ne fushen e legjislacionit per energjine jane kryer studime per njohjen e legjislacionit te rregullatoreve te ketyre vendeve.

Nje ndihme te madhe ne hartimin dhe perpunimin e legjislacionit sekondar ka dhene kompania konsulente amerikane “AEAI“ e financuar nga USAID-i sidomos ne procesin e rishikimit te Modelit te Tregut, te rishikimit te

licensave per aktivitetin e shperndajres, furnizimit (furnizimit publik me pakice dhe me shumice), modelit te marreveshjes se furnizimit me energji elektrike ndermjet furnizuesit publik me pakice dhe me shumice.


Gjate vitit 2008 jane rishikuar dhe perpunuar ne perputhje me amendimet qe ju bene Ligjit “Per sektorin e energjise elektrike” nje numur i madh aktesh nenligjore si:

Rregullat e Tregut te Energjise Elektrike;

License e aktivitetit te shperndarjes se energjise elektrike;

License e aktivitetit te furnizuesit publike me pakice se energjise elektrike;

License e aktivitetit te furnizuesit publike me shumice te energjise elektrike;



*Takim me Kryetarin
e Rregullatorit te
Pensilvanise, Zotin
Wendell F. Holland
Harisburg 14 Maj*



*Takim me Kryetaren
e Rregullatorit te
Washington D.C*



*Takim me Kryetarin e ERRA-s
Z. G. Szoreney Madrid 26 Maj*



Takim me Kryetaren e Rregullatorit te Spanjes Zonjen Maria Theresa Campi Madrid 26 Maj



Shkembim pervoje pune lidhur me privatizimin, me Rregull e Maqedonise. Pogradec 8 Maj



Shkembim pervoje pune per privatizimin, me Rregullatorin e Maqedonise. Pogradec 8 Maj



*Vizite njohese, ne
TEG-in e Vlores ne
ndertim. Vlore 28 Tetor*



*Vizite njohese ne HEC-in e
Bistrices, mbas rikonstruksionit..
Bistrice 11 Dhjetor*



*Vizite njohese ne HEC-
in e Bistrices, mbas
rikonstruksionit.. Bistrice
11 Dhjetor*

- Kontrata tip mes furnizuesit publik me shumice dhe furnizuesit publik me pakice;
- Sistetmi i njejte dhe i standartizuar i llogarive per te licensuarit ne sektorin e energjise elektrike;
- Metodologji e llogaritjes te cmimit per furnizuesin publik me shumice te enrgjise elektrike;
- Metodologji e llogaritjes se tarifese shperndarjes te enrgjise elektrike;
- Metodologji e llogaritjes te cmimit te energjise elektrike per furnizuesin publik me pakice;
- Kodi i Transmetimit se Energjise Elektrike
- Kodi i Shperndarjes se Energjise Elektrike;
- Kodi i Matjes se Energjise Elektrike;
- Rregullore per procedurat e licensimit, ndryshimit, transferimit te plote te pjesshem dhe rinovimit te licnesave;
- License per veprimtarine e tregtimit te energjise elektrike;
- Kodi i funksionimit te rrjetit;
- Rregullore per organizimin dhe furnksionimin e brendshem te ERE-s.

Te gjitha aktet ligjore te miratuara nga Kuvendi i Shqiperise, Modeli i Tregut i miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave dhe te gjitha aktet nenligjore te miratuara nga Bordi i Komisionereve te ERE-s formojne Kuadrin Rregullator ne sektorin e energjise. Kuadri Rregullator ka bere te mundur realizimin e te gjitha mardhenieve legale, administrative dhe financiare, ndermjet te gjith te licensuarve ne tregun e energjise, nga njera ane, dhe konsumatoreve nga ana tjeter, simbas aktesh ligjore e nenligjore, rregullash e procedurash rigorozisht te percaktuara. Nepermjet ketij kuadri rregullator u be e mundur qe procesi i privatizimit te OSSH-es te zhvillohet ne nje terren te organizuar mire nga pikpamja legale dhe te familjarizuar me praktikat me te mira nderkombetare.

4.5. Marredheniet e ERE-s me konsumatorin.

Nje nga detyrat e rendesishme qe buron nga koncepti institucionthemelues i ERE-s eshte parimi i mbrojtjes se konsumatorit nga veprimet arbitrare te subjekteve me status monopol ne tregun e energjise elektrike. Per kete ERE ka shqyrtuar me pergjegjesi te larte te gjitha ankesat e drejtuara nga konsumatorët, ato jane analizuar ne te gjitha aspektet teknike dhe legale sipas nje procedure verifikimi, ballafaqimi dhe gjykimi te paanshem duke respektuar me korektesi qofte afatet e trajtimit por dhe mardhenien informuese dhe skjaruese me ankuesit.

ERE gjithashtu, ne perputhje me autoritetin qe i jep ligji, ka zgjidhur me kompetence edhe ankesat dhe mosmareveshjet ndermjet te licensuarve, ose te licensuarve dhe institucioneve te ndryshme

Ne praktiken e trajtimit te ankesave te konsumatorit, konstatojme se ato kryesisht kane te bejne me faturimin e energjise elektrike nga OSSH sh.a ne nivele me te larta nga ato te regjistruara ne mates, ne rastin e klienteve te pajisur me mates, dhe ne rastin e klienteve pa mates, eshte evidentuar faturimi tej vlerave te faturimit aforfe te miratuara nga ERE, si dhe nderprerje te energjise elektrike per shkak te mospagesave. Po ashtu eshte ndeshur edhe problemi i mos hapjes se kontratave te reja per shkak te debive te mbartura nga konsumatori. Nga trajtimi i ankesave kane rezultuar te pabazuara vetem 7 ankesa nga 42, te trajtuara gjate vitit. Ne te gjitha rastet e zgjidhjes se mosmareveshejve eshte proceduar duke percjelle shqetesimin e konsumatorit ne OSSH sha. dhe duke kerkuar fillimisht sqarime nga ky i fundit. Ne vijim jane shqyrtuar pretendimet e konsumatorit nga njera ane dhe te OSSH sh.a nga ana tjeter dhe kur eshte pare e nevojshme jane organizuar ballafaqime te paleve ne seanca te posacme degjimore. Se fundi, bazuar ne legjislacionin ne fuqi ne sektorin e energjise elektrike eshte proceduar me zgjidhjen e mosmarreveshjeve.

Eshte me rendesi te theksojme, se me zgjidhjet e akorduara nga ERE, nuk ka pasur kundershime nga palet, por ne te kundert, ERE-s i jane drejtuar disa letra falenderimi per trajtimin dhe zgjidhjen ko- rekte te ankesave, nga ana e konsumatoreve.

Ne vijim te punes per ofrimin e informacionit konsumatoreve, ERE i ka kushtuar vemendje edhe vendosjes se informacioneve mbi konsumatorin ku eshte krijuar edhe hapësira e konsumatorit ne fa- qen tone ne internetit, te cilat u jane dhene personave te interesuar qe jane paraqitur ne ERE per çeshtje te ndryshme. Ne keto broshura konsumatori gjen informacion mbi menyren e formulimit te anke- ses, mbi kontraten e furnizimit me energji elektrike dhe ceshtjet e te drejtave dhe detyrimeve te tij, ku mund te ankohet per ceshtjet qe lidhen me furnizimin me energji elektrike etj.

Ne kuader te zgjidhjes se mosmarreshjeve midis te licensuarve, kemi trajtuar shqetesimet e tyre dhe shume here kemi organizuar seanca degjimore. Mosmarreshjet kryesisht kane konsistuar ne percaktimin e rregullimeve ne kontraten per sherbimet ndihmese qe lidhet midis paleve, apo ne rastin e prodhuesve te vegjel, ku problem shqetesues per ta ka qene mos rakordimi per sasine e energjise elektrike te levruar prej tyre, apo per mospagesat e energjise elektrike te shitur.

Sikuresse ne rastin e informacionit sqarues per konsumatoret, edhe ne rastin e te licensuarve apo te aplikuesve per pajisje me license kemi ofruar asistencen tone, per te sqaruar procedura te caktura si p.sh: ne kuader te licensimit kemi skjaruar se cfar dokumentacioni nevojitet per nje aplikim etj.

Nje mardhenie e rendesishme e ERE-s me te licensuarit eshte edhe ajo e shqyrtimit te aplikimeve dhe e marrjes se vendimeve perkatese qofte per licensime ne sektorin e energjise por edhe per probleme te tjera si me poshte:

- Shqyrtimin e aplikimit te OSSH per perckatimin e cmimit te shi- tjes se energjise elektrike per konsumatoret tarifore;

- Shqyrtimin e aplikimit të KESH për përcaktimin e cmimit të prodhimit të energjisë elektrike;
- Shqyrtimin e aplikimit të OST për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike;
- Shqyrtimin e aplikimeve për licenca nga subjekte të ndryshme të interesuara për të ushtruar aktivitet në sektorin që licensohet nga ERE;

Një aspekt i rëndësishëm i mardhenieve transparente të ERE-s me publikun dhe me opinionin publik në përgjithësi është edhe publikimi në faqen e ERE-s në internet (www.ere.gov.al) në rubrikën e specializuar për legjislacionin, aktualitetin, publikimet etj. të një informacioni të gjere dhe të gjithëpërfshirës të veprimtarisë së institucionit të tyre. ERE vazhdimisht ka qenë e hapur me mediat elektronike dhe të shkruara për t'ju përgjigjur interesimit të tyre dhe të opinionit publik, për të gjitha problemet që lidhen me veprimtarinë dhe kompetencat tona institucionale.

4.6. Veprimtaria ndërkombëtare e ERE-s.

Për vitin 2008, Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike ka vlerësuar si mjaft të rëndësishëm zhvillimin e mardhenieve të tij institucionale edhe në shkallë ndërkombëtare. Një gjë e tillë është ka shërbyer veç të tjerash edhe rritjes dhe forcimit të kapaciteteve profesionale të burimeve të veta njerezore, në mënyrë që të ushtrojë autoritetin e tij rregullues në sektorin e energjisë në Shqipëri, në përputhje me përvojat me të mira të vendeve të rajonit e me gjere.

ERE ka bërë përpjekje në shkallë rajonale për krijimin e një tregu rajonal transparent dhe konkurrues të energjisë elektrike si dhe për integrimin e vendit të tyre edhe në tregun evropian. ERE në veprimtarinë e vet, ka vlerësuar dhe marrë në konsideratë Direktivat dhe Rekomandimet e BE-së dhe të Traktatit të Komunitetit të Energjisë

per energjine elektrike dhe gazin natyror.

ERE ka ndjekur rregullisht Forumet e Athinës dhe aktivitetet e Komunitetit te Energjise te organizuara nga Sekretariati i Vjenes, sic kane qene takimet e rregullta te Grupeve te punes per ceshtjet e konsumatoreve, alokimit te kapaciteteve, tregut rajonal te energjise, si dhe (me atributet e dhena nga Ligji per Gazin Natyror) takimet per ceshtjet e gazit. Keto janë aktivitete tepër të rëndësishme që nxisin pjesëmarrjen e vendeve te rajonit te Evropes Juglindore në strukturat e krijuara me qëllim final integrimin e tyre në Bashkimin Evropian dhe me synim krijimin e një tregu rajonal të energjisë, transparent, konkurues, jo diskriminues dhe me akses te barabarte per te gjithë pjesmarresit.

Sikurse dhe me pare, rritja e aftesive teknike dhe profesionale, si dhe eksperiencia dhe kualifikimi i antareve te Bordit te Komisionereve dhe e gjithë personelit ne pergjithesi, ne perputhje

me shkallen perkatese te kualifikimit, ka qene nje nga drejtimet kryesore te punes se ERE-s gjate vitit 2008. ERE ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh, konferencash e seminaresh të zhvilluara midis vendeve të rajonit por edhe më gjerë. Ne partneritet te ngushte me USAID-in dhe Shoqaten e Rregullatoreve te SHBA-se (NARUK) si dhe me Rregullatorin e Italise, gjate vitit 2008, perfaqsesit e ERE-s kane marre pjese ne dy takime te perbashketa pune ku eshte shkemb-yer nje pervojë e vyer ne fushen e rregullimit te sektoreve te energjise elektrike dhe gazit natyror.

Institucione te rendesishme trajnimi dhe kualifikimi per ERE-n kane qene Shkollat e Rregullimit te Firences dhe Budapestit, ne te cilat u trajnuan komisionere dhe personel i te gjitha niveleve me pjesmarje te drejteperdrejte por edhe nepermjet edukimit ne distance. Nder me te rendesishmet mund te permendim trajnimet per monitorimin e tregut te energjise, ate te sistemit te llogarive, trajnimi per rregullimin e tarifave, per procedurat e licensimit, per aspektet e legjislacionit sekondar dhe te kuadrit rregullator ne pergjithesi.



*Ne Konferencen per
Energjine te Evropes
Qendrore dhe Lindore.
Prage 26-27 Shkurt*



*Ne Takimin e Asamblese
se Pergjitheshme te
MEDREG Madrid
26 Maj*



*Ne Takimin e Komisionit
Ekonomik Evropian te
OKB-es per Energjine
Gjeneve 19-21 Nentor*



*Ne Takim me Ministren e
Energjetikes te Kosoves Zonjen
Justina Shiroka Pulaj*

*Ne Takim me Ministren
e Energjetikes te Kosoves
Zonjen Justina Shiroka
Pulaj dhe me Drejtuesit e
Operatorit te Sistemit te
Transmetimit "KOST"
Prishtine 2 Prill*



*Takim me Kryetarin e Zyres
Rregullatore te Republikes
se Kosoves Zotin Ali Hamiti
Prishtine, 3 Prill*



*Ne Konferencen e 7-te te
ERRA-s ne Budapest, 21-24
Prill. Zonja Erideta Basha
duke referuar*



*Ne mbledhjen e Komitetit te
Kryetareve te Rregullatoreve
anetare te ERRA-s, ne Vilnius
20-21 Tetor*

ERE është anëtare me te drejta te plota ne Shoqatën e Enteve Rregullatore të Vendeve të Europës Juglindore dhe EuroAzisë (ERRA) dhe ndjek takimet e dy Komiteteve të përhershme të ERRA-s, atij të Liçensimit e Monitorimit dhe Tarifave e Çmimeve si dhe te Grupit te Punes se Juristeve. Këto Komitete zhvillojnë takime 2-3 herë në vit në bazë të një programi vjetor, ku diskutohen dhe trajtohen çështje që shqetësojnë rregullatorët e vendeve mbi këto fusha mjaft të rëndësishme për veprimtarinë e tyre. Persa i perket trajnimeve te organizuara nga ERRA, ERE ka marre pjese ne trajnimin per Komisioneret e rinj dhe stafin e ri te rregullatoreve, si dhe ne nje trajnim te vecante qe eshte zhvilluar teresisht per ceshtjet e gazit dhe rregullimin e tij.

ERE eshte anetare e MEDREG (Rregullatorët e vendeve të Mesdheut) ku ndjek rregullisht takimet e grupeve te punes per energjite e rinovueshme dhe ceshtjet e gazit, si dhe takimet e Asamblese se Pergjithshme te ketij organizmi mesdhetar. Nepermjet ketij organizmi koordinohet puna per njohjen e mundesive dhe potencialev energjetike te Vendeve te Mesdheut dhe per krijimin e nje klime mirekuptimi dhe bashkepunimi te rregullatoreve te ketyre vendeve per probleme me interes reciprok si bashkeveprimi ne drejtim te harmonizimit te rregullave, aksesit ne rrjet dhe shfrytezimit te burimeve.

Gjate vitit 2008 ERE ka treguar vazhdimisht nje interes te dukshem per eksperiencat energjitike evropiane dhe me gjere ne shkalle boterore nepemjet pjesemarrjes se saj ne aktivtete nderkombetare ku mund te permendim Konferencen per energjine per vendet e e Europes Juglindore, Forumet Evropiane per Energjine, Forumin e KransMontanes, Konferencat per tregjet Evropiane dhe Konferencat e organizuara per ceshtjet e gazit ne vendet e rajonit. Bazuar edhe ne marrveshjet bilaterale te nenshkuara me institucionet homologe te rajonit ERE ka punuar ne drejtim te nje bashkepunimi me baza bilaterale, duke e vene theksin ne mbeshtetje teknike, vizita studimore dhe kualifikime ne drejtim te ngritjes profesionale te stafit te saj ku mund te permendim ketu vizitat e shkembimit me Entin Rregullator

Italian dhe ate te Maqedonise te cilat jane vleresuar te frytshme vecanerisht per pervojen ne fushen e privatizimit te OSSH-es.

4.7. Mbi marrëdhëniet e ERE-s me Kuvendin e Shqipërisë.

Gjate vitit 2008 mendojme se ka pasur nje permiresim te metejshem te marrëdhënieve institucionale te ERE-s me Kuvendin e Shqipërisë dhe posacerisht me Komisionin e Veprimtarive Prodhuese, Tregtise dhe Mjedisit.

Per problemet me te rendesishme qe kane pasur zhvillimet ne sektorin e energjise elektrike, ERE e ka mbajtur ne korent Kuvendin dhe e ka informuar per menyren e trajtimit te tyre. Pervec trajtimit ne Kuvend te Raportit per vitin 2007, ERE e ka informuar Kuvendin per Modelin Shqiptar te Tregut, per hartimin e akteve nenligjore, per privatizimin e sektorit te shperndarjes se energjise elektrike, per cmimet dhe tarifat e energjise elektrike.

Nje hap i rendesishem per vendosjen e marrëdhënieve institucionale te ERE-s me Kuvendin ne nje baze me te shendoshe dhe te nje komunikimi me te ngushte eshte pa dyshim edhe Vendimi i Byrose se Kuvendit No.29, date 09.07.2008 „Per ngritjen e Sherbimit te Monitorimit te institucioneve qe raportojne dhe informojne Kuvendin“.

Me ngritjen e ketij sherbimi, ERE ka vendosur me Kuvendin nje marrëdhënie te re bashkepunimi dhe informimi periodik, ne baz te se cilit pasqyrohet me mire veprimtaria institucionale e ERE-s dhe nga ana tjetër Kuvendi ushtron ndaj ERE-s ne menyre te drejteperdrejte kontrollin Parlamentar.

Ne kete kuader, Keshilltarja e ketij sherbimi, qe mbulon veprimtarine e ERE-s, eshte njohur ne menyre te hollesishme mbi veprimtarine korente te ERE-s dhe nga ana tjetër ajo ka asistuar ne disa mbledhje te Bordit te Komisionereve te ERE-s.

ERE ndjen detyrimin te shprehe falenderimet e veta per mbeshtetjen qe i kane dhene Komisionet e Kuvendit dhe Kuvendi ne

teresi veprimtarise se tij por nga ana tjetere e ndejme te nevojshme te theksojme se eshte me shume rendesi per veprimtarine e metejshme te ERE-s miratimi i shteses ne organiken egzistuese te ERE-s i 6 punonjesve pa ndryshuar strukturen e miratuar, kerkes kjo qe buron nga Ligji nr 9946, date 30.06.2008 “Per Gazin Natyror” sipas te cilit ERE merr edhe pergjegjesite dhe atributet e Rregullatorit ne sektorin e Gazit Natyror ne Shqiperi. Per fat te keq kjo kerkese e ERE-s e paraqitur ne Kuvend me nr.702, date 5.11.2008 ende nuk eshte trajtuar per miratim.

ERE angazhohet se ne te ardhmen do ta shpjere me teje praktiken e bashkepunimit me Kuvendin dhe do ta do ta kete ate sikurse edhe deri me sot, nje nga perpresite e punes se tij.

4.8. Struktura organizative dhe menyra e funksionimit te ERE-s.

Struktura ekzistuese e ERE-s eshte e organizuar ne tre njesi themelore :

- a) Bordi i Komisionereve
- b) Stafi i ekspertizes teknike
- c) Stafi mbeshtetes

4.8.1. Bordi i Komisionereve

Ne strukturen e Bordit te Komisionereve bejne pjese:

1. Kryetari i Bordit.
2. Kater antare te Bordit.
3. Keshilltari i Bordit.
4. Sekretaria e Bordit.

Gjithesej 7 punonjes.

Ne perputhje me ligjin nr.9072 date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike” te ndryshuar, Kryetari dhe kater antaret e Bordit zgjidhen nga Kuvendi i Shqiperise dhe perfaqesojne strukturen vendim-marrese te institucionit. Gjate vitit 2008 Bordi i Komisionereve mori 144 vendime

Ne baze te po ketij ligji, Kryetari i Bordit eshte njekohesisht edhe administratori egzekutiv i ERE-s.

4.8.2. Stafi i ekspertizes teknike.

Eshte i organizuar ne tre drejtori dhe nje sektor:

1. Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave te Energjise Elektrike, me 5 punonjes.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit, me 7 punonjes.
3. Drejtoria e Juridike dhe Mbrojtjes se Konsumatorit, me 5 punonjes.
4. Sektori i mardhenieve me jashte me 1 punonjes
Gjithesej 18 punonjes.

4.8.3. Stafi mbeshtetes.

Eshte i organizuar ne Drejtorine e Administrate-Finances dhe Burimeve Njerezore me gjithesej 7 punonjes.

1 Drejtor, 1 Arketar-arkivist-magaziner, 1 Specialist IT, 3 shofere dhe 1 Sanitare.

Struktura ekzistues e ERE-s, sipas Vendimit te Kuvendit te Shqiperise Nr 181, date 5.5.2008, perbehet nga gjithesej 32 punonjes.

Ne Aneksin ”A1”, bashkalidhur, paraqitet organograma dhe numri i punonjesve te struktures egzistuese te ERE-s.

Mosha mesatare e puonjesve ne vitin 2008 ishte 38.4 vjet.

Me perjashtim te 4 punonjesve te sherbimit, i tere personeli prej 28 punonjesish, eshte me arsim te larte. Te gjithë punonjesit zo-

terojne gjuhen angleze dhe 30% e tyre zoterojne te pakten edhe nje gjuhe tjeter. 21.4% e punonjesve jane me grade shkencore (3 doktore shkencash dhe 3 me graden master).

Nga 28 punonjes administrativo – teknik, 17 prej tyre ose, 60.7% jane femra. Ne pozicionin vendim-marres, femrat zen 20% te vendim-maresve, ndersa ne pozicionet drejtuese ato zene 53.8%, te personelit drejtues. 5 nga punonjesit tane bejne pjese ne jeten akademike universitare si pedagoge te jashtem.

I tere personeli vendim-marres i eshte nenshtruar trajnimeve ne shkollat e specializuara evropiane te rregullimit ne fushen e energjise. Te njejtat parime jane respektuar edhe per personelin drejtues dhe punonjesit e tjere, duke ndjekur te njejtat shkolla, por me programe per nivele te ndryshem qe nga fillestaret dhe deri te personeli me pervoje.

Financimet per kualifikimin dhe trajnimin e personelit ne rreth 70% te shumes, jane mbuluar nga buxheti i ERE-s, kurse pjesa tjeter eshte sponsorizuar nga shoqatat evropiane dhe amerikane te rregullatoreve si ERRA, NARUK, MEDREG dhe rregullatore te tjere, me te cilet kemi marredhenie bashkepunimi.

E tere baza logjistike e ERE-s eshte e ndertuara sipas koncepteve dhe teknologjise bashkekohore, po keshtu edhe mjediset e punes jane te pajisura dhe te ndertuara ne menyre qe te krijojne kushte optimale per realizimin e detyrave nga cdo punonjes.

4.9. Trajtimi i burimeve njerezore te ERE-s.

Edhe per vitin 2008 persa i takon fushes se Burimeve Njerezore eshte zbatuar me perpikmeri Ligji nr.9367 date 07.04.2005” Per parandalimin e konfliktit te interesave ne ushtrimin e funksioneve publike” dhe Ligjit nr.9049, date 10.04.2003” Per deklarimin dhe kontrollin e pasurive, te detyrimeve financiare te te zgjedhurve dhe te disa nepunesve publik”.

Jane plotesuar deklaratat e interesave private periodike/vjetore nga te 9 zyrtaret (qe mbartin kete detyrim), brenda afateve kohore dhe nuk kemi asnje shkelje per sa i takon afateve kohore te zbatimit te ligjit..Gjithashtu kemi marre pjese rregullisht ne trajnimet e organizuar nga ILDKP.

Ne muajin shkurt u krye nje kontroll nga inspektoret e ILDKP, nga ana e te cileve nuk u kostatua asnje shkelje ligjore.

Ne zbatim te Vendimit nr.181, date 05.05.2008 te Kuvendit te Shqiperise per miratimin e struktures dhe organikes eshte zbatuar me perpikmeri Ligji nr.9584 date 11.07.2006, "Per pagat shperblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe te institucioneve te tjera te pavarura te krijuara me ligj." si dhe Vendimi nr.901, date 19.12.2007 i ndryshuar me vendimin nr.1001, date 2.7.2008" Per miratimin e struktures dhe te niveleve te pagave te nepunesve civil/nepunesve te kabineteve dhe punonjesve mbeshtetes ne administraten e disa institucioneve te pavarura “.

Ne vijim te Ligjit nr.9072, date 22.5.2003 ” Per Sektorin e Energjise” i ndryshuar, per perzgjedhjen, emerimin dhe promovimin ne detyre te personelit eshte zbatuar ligji nr.8549, date 11.11.1999 i “Statusit te nepunesit civil”



Nga nje veprimtari shoqerore e punonjesve te ERE-s

4.10. Administrimi i burimeve financiare te ERE-s.

Ne fushen e administrimit dhe finances jane zbatuar me korekte-si legjislacionet perkatese per administrimin e financave te ERE-s, te tille si ligji nr.9072 date 02.05.2003 “ Per sektorin e energjise elektrike” me ndryshimet perkatese, ligji nr.9643, date 20.11.2006 per “ Prokurimet Publike” te ndryshuar, Ligji nr.7661 “Per kontabilitetin”, si dhe te tjera legjislacione.

Jane zbatuar te gjitha afatet kohore ne lidhje me dorzimin e realizimin e rregjistrimit te prokurimeve te fondeve publike, ne perputhje me ligjin e prokurimeve duke i asistuar te gjitha procedurat perkatese edhe asistense juridike

Ne fillim te vitit 2009 u pergatit bilanci i ERE-s per vitin 2008, dhe ne vijim eshte pergatitur ne perputhje me nevojat e ERE-s, projekt- buxheti per vitin 2009. Plani i te ardhurave dhe shpenzimeve eshte miratuar ne Bordin e Komisionereve dhe per respektimin e tij Bordi eshte informuar ne menyre periodike. Bilanci i ERE-s eshte audituar nga nje ekspert kontabel i Autorizuar dhe rezultati eshte miratuar ne Bordin e Komisionereve.

Nga ana e institucionit eshte kryer inventarizimi i pasurise qe ERE ka ne administrim. Per sa i takon fondeve monetare, ato sigurohen nga pagesat e rregullimit qe ERE u ka caktuar te licensuarve. Per vitin 2008 te ardhurat e planifikuara nga pagesat e rregullimit jane realizuar 70%. Pagesa e rregullimit qe iu caktua KESH sh.a per vitin 2008 u realizua 67%. Per sa i perket te licensuarve te tjere arketimet jane realizuar ne masen 100%.

Bilanci i shpenzimeve te kryera nga ERE, si pjese e permbushjes se detyrimit ligjor per te garantuar nje pune normale te institucionit, si edhe me pare kane konsistuar ne permbushjen e nevojave me te domosdoshme qe ka pasur ERE gjate vitit, ku permendim si me kryesoret:

- Pagat e personelit, kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore, tatimet mbi te ardhurat, per te cilat institucioni


yne ka shlyer te gjitha detyrimet dhe nuk eshte debitor.

- pagesat per konsulenca
- Publikimet per informim te opinionit publik
- Pagesat per shlyerjet e detyrimeve te sherbimeve si uje, energji elektrike, telefon per te cilat institucioni yne gjithashtu nuk eshte debitor, shpenzime per sherbime te domosdoshme per mbarvajtjen e punes si dhe amortizimi i aktiveve te qendrueshme te trupezuara.etj.

E R E T I R A N E			
	A K T I V I	31.12.2007	31.12.2008
I	AKTIVET AFATSHKURTRA	29,072,596.00	24,903,254.00
	Aktivet Monetare	27,753,419.00	5,820,611.00
	Aktive te tjera financiare afatshkurtra	89,332.00	16,563,447.00
	Inventar	1,229,844.00	2,519,195.00
II	AKTIVET AFATGJATA		
	Aktivet Afatgjata Materiale	21,544,413.00	20,253,716.00
	TOTALI I AKTIVIT	50,617,009.21	45,156,970.00
	P A S I V I	31.12.2007	31.12.2008
	Pasivet Afatshkurtra	1,628,109.00	18,868,148.00
	Huate dhe parapagimet	1,628,109.00	2,308,148.00
	Grande dhe Te ardhura te Shtyra		16,560,000.00
	KAPITALI	48,988,900.00	26,288,822.00
	TOTALI I PASIVIT	50,617,009.21	45,156,970.00

Gjithashtu jane kryer procedurat e prokurimeve ne kuader te blerjeve te vogla (si pjese e Komisionit te blerjeve Vogla) ne zbatim te ligjeve te prokurimeve per fondet publike.

Veprimtaria ekonomiko-financiare e ERE-s gjate vitit 2008 eshte audituar nga nje ekspert kontabel i pavarur dhe i licensuar per kete aktivitet.



V. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME.

5.1 Perfundime dhe Rekomandime.

Ne perfundim te kesaj analize mbi veprimtarine sektorit te energjise ne teresi dhe te ERE-es ne vecanti e gjujojme te dobishme qe te sintetizojme disa konkluzione dhe te formulojme disa rekomandime te cilat mendojme se do te ishte e frytshme qe te merren parasysh qofte ne veprimtarine e vete ERE-s por edhe ne veprimtarine e institucioneve te tjera qe lidhen me sektorin elektrik ne pergjithesi.

Sikurse e kemi theksuar vazhdimisht per cdo vit, sfida qendrore dhe me determinuese ne gjithe efektivitetin e sektorit elektrik ne vendin tone vazhdon te mbetet sfida per reduktimin sinjifikativ te humbjeve te energjise elektrike qofte atyre teknike dhe vecanerisht atyre jo teknike. Ne se deri ne vitin 2008 ajo i perkiste KESH-it si shoqeri e integruar vertikalisht ne vitin 2008 ajo i perkete ne menyre te vecante OSSH-se. Humbjet ne shperndarje perbejne rreth 96% te te gjitha humbjeve ne sektorin e energjise elektrike.

Deri me sot ekipet menaxheriale qe kane administruar KESH-in ne teresi dhe sektorin e shperndarjes ne vecanti nuk kan qene te sukseseshme ne reduktimin e humbjeve. Megjithate sfida per te eleminuar vjedhjet e energjise elektrike dhe mospagesen e saj nuk

eshte nje sfide vetem per aftesite menaxheriale te OSSH-se. Ajo eshte nje sfide edhe per institucionet e shtetit qe parandalojne dhe luftojne krimin ekonomik. Ajo eshte gjithashtu nje sfide per te gjitha shoqerine e sotme ne vendin tone.

ERE e vlereson si nje te mete te rendesishme te KESH-it dhe OSSH-se moskompletimin me matesa te klienteve tarifor. KESH dhe OSSH nuk kan qen ne gjendje te sigurojne sasine e mjaftueshme te matsave per te plotesuar te gjitha kerkesat e klienteve tarifor dhe ne menyre te perseritur ne dhjetor 2008, OSSH ka aplikuar ne ERE per shtyrjen e faturimit aforfe deri ne 31 Dhjetor 2009. ERE terheq vemendjen e OSSH-se, qe mbetet ne te ardhmen e vetmja pergjegjese per realizimin e kesaj detyre, se me faturimin aforfe paguhet vetem nje pjese e energjise elektrike te konsumuar pa limit nga klientet pa matesa. OSSH nga mosplotesimi me matesa i klienteve tarifor peson humbje te konsiderueshme financiare, prandaj eshte e domozdoshme qe kjo praktike te marre fund nje here e pergjithmone brenda vitit 2009.

ERE vlereson punen e mire te kryer nga KESH-i ne shfrytezimin e rezerves hidroenergetike te kaskades se lumit Drin, nepermjet nje harmonizimi te kenaqeshme te prodhimit vendas me importin, duke ruajtur gjate gjithë vitit kuota te larta shfrytezimi ne liqenin e Fierzes dhe per pasoje duke prodhuar rreth 30% me shume energji elektrike kundrejt vitit 2007, per te njejten sasi uji te depozituar ne liqen.

ERE inkurajon KESH-in qe te shfrytezoje me tej perpaesite qe i sjell prodhimi i energjise elektrike nga nje kaskade me rregullim vjetor, per te rritur me tej efektivitetin e energjise elektrike te prodhuar prej saj nga shfrytezimi i diferences se cmimeve te energjise elektrike ne tregun rajonal gjate oreve te pikut te ngarkeses dhe jashte tij. ERE do te krijojë, me autoritetin qe i lejon ligji, kuadrin e nevojshem procedural ne menyre qe nje perpaesi e tille te behet e zbatueshme.

ERE e vlereson si nje arritje shume te rendesishme, zbatimin nga ana e KESH-it dhe OSSH-se, me mbeshtetje edhe te Qeverise, te furnizimit me energji elektrike te klienteve tarifar, pa nderprerje te planifikuara, vecanerisht ne kushtet tejet te disfavoreshme te konjuktures se tregut rajonal, me cmime shume te larta importi.

Tarifat e energjise elektrike te miratuara nga ERE per vitin 2008 reflektojne parimet e rendesishme te publikuara prej saj ne vitin 2007 te cilat jane ne perputhje me praktikat me te mira nderkombetare dhe direktivat e BE-se. Nepermjet sistemit tarifar te miratuar, ERE i kushtoi vemendje shume te madhe ruajtjes se balances se domozdoshme ndermjet mbulimit te shpenzimeve vjetore nga ana e shoqerive KESH, OSSH dhe OST nga njera ane dhe aftesise paguese te klienteve, vecanerisht atyre familjare, nga ana tjetere. ne menyre qe tarifat te mos ishin shokuese per ta dhe te sillnin per pasoje rritjen e mosarketimeve.

Tarifat e energjise elektrike jane te ndervarura kryesisht nga sasia dhe cmimet e importit te energjise elektrike dhe niveli i pergjithshem i humbjeve. Ne keto kushte, furnizimi pa nderprerje me energji elektrike ka kosto me te larte se furnizimi me nderprerje te planifikuara ne bllok. Vecanerisht tempet e “cmendura” te rritjes se cmimeve te importit te energjise elektrike sjellin nje rritje te madhe te shpenzimeve nga ana e shoqerive OSSH dhe KESH te cilat duhet te mbulohen nga shitja e energjise ne menyre qe keto shoqeri te mbijetojne. Ndonse roli i ERE-s per te vendosur ekuilibret e domozdoshem ne tregun e rregulluar te energjise elektrike nga nderveprimi i faktoreve te permendur me larte eshte i veshtire, ERE do te beje te gjitha perpjekjet per optimizimin e zgjidhjeve.

Cdo qytetar, i cili e pervehteson ne menyre te paligjeshme energjine elektrike, cdo qytetar i cili nuk e paguan faturen e energjise elektrike, eshte nje kontribues ne rritjen e cmimeve te energjise elek-

trike. Mospagesa e energjise elektrike perben nje nga krimet me te renda ekonomike ne vendin tone. Cdo indiference, neglizhence apo mosveprim ndaj kesaj dukurije, nga ana e vet shoqerive te energjise, organeve shteterore kompetente por dhe e mediave, te cilat ndikojne ne formimin e opinionit publik, bejne qe te penalizohet pjesa me e madhe e shoqerise, e cila e respekton pagesen e konsumit te energjise elektrike.

ERE vlereson ne menyre te vecante, punen e madhe te kryer gjate vitit 2008, per krijimin e nje kuadri ligjor e nenligjor bashkekohor, ne sektorin e energjise elektrike, i cili krijoi shtratin e nevojshem legal per zhvillimin me sukses te procesit te privatizimit te OSSH-se, si sfiden me te veshtire dhe njekohesisht me te rendesishme ne Sektorin e Energjise Elektrike. ERE vlereson transparencen, mosdiskriminimin, konkurencen e ndershme dhe profesionalizmin ne te gjitha procesin e promovimit dhe konkurimit deri ne shpalljen e fituesit ne tenderin nderkombetar te zhvilluar per kete qellim. ERE gjithashtu vlereson shoqerine ceke "CEZ", fituese te tenderit, si nje shoqeri me kredibilitet nderkombetar dhe me aftesi te spikatura financiare, menaxheriale dhe profesionale

Si nje arritje te rendesishme gjate vitit 2008 ne sektorin e energjise elektrike, ERE vlereson shkallen e madhe te pjesmarrjes se investimeve private ne ndertimin e burimeve te reja elektroenergjetike. Dhenia me koncension e 31 hidrocentraleve me fuqi te mesme dhe te vogel me kapacitet 530 MW dhe prodhim te pritshem 1,760 GWh si dhe licensimi per ndertimin e 7 parqeve eolike per prodhim energjie elektrike me kapacitet 1367 MW dhe prodhim te pritshem 3,100 GWh, jane nje garanci e rendesishme per zgjidhjen me sukses te kerkeses per energji nga burimet lokale per nje periodhe afatmesme.

Me Ligjin Nr.9946, date 30.6.2008, "Per Sektorin e Gazit Natyror", ERE-es j'u delegua edhe funksioni i rregullimit ne sektorin

e gazit natyror. Rikrijimin e tregut të gazit natyror në Shqipëri ERE e vlerëson si një faktor me rëndësi që do të ndikojë në rritjen e tempeve të zhvillimit ekonomik-shoqëror të vendit dhe vecanerisht të sektorit të energjisë elektrike. Në këtë kuadër ERE do të jetë shumë aktive dhe do të bëjë të gjitha përpjekjet brenda kompetencave dhe fushës së veprimtarisë së sajë për lidhjen e Shqipërisë me rrjetin ndërkombëtar të gazit natyror, sipas projekteve më të leverdisëshme për interesat tona kombëtare.

Si një institucion i ekspertizës së shtetit në fushën e energjisë, ERE mbështet politikën e Qeverisë për zgjidhjen afatgjatë të kërkesës së vendit për energji elektrike nëpërmjet ndërtimit të një centrali nuklear për prodhimin e energjisë elektrike me investime private. Alternativa nukleare e prodhimit të energjisë elektrike, si një alternative miqësore ndaj mjedisit, me prodhim energjie elektrike me kosto relativisht të ulët dhe me një evoluim teknologjik-konstruktiv të këtyre objekteve që garanton një shkallë të lartë sigurie nga aksidentet nukleare, është pranuar sot në shkallë të gjere nga strategjitë e zhvillimit energjetik evropian dhe global.

ERE mban një qëndrim konsistent, prandaj rithekson edhe një herë, se për të operuar me sukses në Tregun Rajonal të Energjisë Elektrike prioriteti i politikave të investimeve publike dhe private në sektorin e transmetimit të energjisë elektrike mbetet realizimi i arterive të interkoneksionit me Malin e Zi, Kosovën, Maqedoninë dhe Italinë si dhe të gjithë infrastrukturës që lidh me to (n/Stacionet dhe Qendra Kombëtare Dispecer). ERE e vlerëson fillimin e punimeve për ndërtimin e shpejtë, brenda vitit 2009, të linjës së interkoneksionit 400 kV me Malin e Zi dhe dhenien e lejeve nga Keshilli i Ministrave për ndërtimin e dy linjave nënujore të interkoneksionit me Italinë si një hap të rëndësishëm integruar në rrjetet rajonale dhe evropiane të energjisë elektrike.


ERE ne veprimtarine e vet, per nje periudhe te gjate ka shpenzuar dhe vazhdon te shpenzoje, sikurse theksohet ne raport, shuma te konsiderueshme per kualifikimin dhe trajnimin e punonjesve ne menyre qe ata te aftesohen ne nivele profesionalisht te denja per tu perballur me ekspertizen gjithnje e me te kualifikuar te shoqerive private te licensuara.

Ne kushtet e konkuresces se tregut te punes, vecanerisht kur ndjehet mungesa e nje numuri ekspertesh me specializim te larte specifik, te cilet perfaqsojne asetet humane me vlere te madhe, kane filluar te shfaqen perpjekjet, per ti terhequr ata, nepermjet joshjes me paga te larta.


Largimi i eksperteve cilesor sjell nje dem te pallogaritshem jo vetem ne institucionin perkates por mbi te gjitha, ne rastin konkret te ERE-s, te klientet tarifor. Ne keto rethana i rekomandojme Kuvendit dhe Qeverise qe te adoptoje ne politiken e pagave per institucione dhe kontigjente te caktuara te tyre, kategorizime te tilla qe do te shmangnin nje hemoragji te kesaj natyre. ERE eshte e gatshme te jape bashkepunimin e vet per te gjetur zgjidhjet me te mira.

Ne konkluzionet dhe rekomandimet e paraqitura me siper jane evidentuar problemet qe i gjykojme se jane me te rendesishmit per tu pasur vazhdimisht ne konsiderate per ndjekje deri ne zgjidhjen e tyre.


Aneks “A” 1



Aneks “A” 2



Grafiket ditore te prodhimit, importit, konsumit te energji elektrike dhe hidroenergjetike ne Liqen dhe rezerva hidroenergjetike ne fliere, viti -2008-



Produktimi elektrik dhe nivelit, sasise se prurjeve si dhe rezerves in e Fierzes per vitin 2008

